



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raporti për Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkia Konispol”**

## **RAPORTI I AUDITIMIT**

### **Auditim Financiar**

**Tiranë, 2024**

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>3</b>
<b>I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.....</b>	<b>5</b>
<b>II. HYRJA.....</b>	<b>6</b>
<b>OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.....</b>	<b>6</b>
<b>1. Objektivat dhe qëllimi .....</b>	<b>6</b>
<b>2. Identifikimi i çështjes.....</b>	<b>7</b>
<b>3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</b>	<b>7</b>
<b>4. Përgjegjësitë e audituesve .....</b>	<b>8</b>
<b>5. Kriteret e vlerësimit .....</b>	<b>8</b>
<b>6. Standardet e auditimit .....</b>	<b>10</b>
<b>7. Metodatat e auditimit .....</b>	<b>10</b>
<b>8. Dokumentimi i auditimit.....</b>	<b>11</b>
<b>1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Konispol” .....</b>	<b>12</b>
<b>2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit .....</b>	<b>13</b>
<b>1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....</b>	<b>13</b>
<b>2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.....</b>	<b>27</b>
<b>3. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.....</b>	<b>42</b>
<b>4.TË NDRYSHME TË DALA GJATË AUDITIMIT.....</b>	<b>61</b>
<b>IV. REKOMANDIME .....</b>	<b>63</b>
<b>D. MASA DISIPLINORE .....</b>	<b>75</b>

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### ***a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:***

Bashkia Konispol, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Konispol për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

a. Për vitin 2023 nga Bashkia Konispol janë shpenzuar gjithësej 295,914 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 281,140 mijë lekë; për shpenzime operative në vlerën 67,531 mijë lekë; për transfertat koherente të brendshme 1,918 mijë lekë; për ndihma ekonomike invaliditeti në vlerën 46,521 lekë; për investime në vlerën 92,150 mijë lekë.

b. Për vitin 2023 Bashkia Konispol nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithësej vlerën 33,792 mijë lekë.

### ***b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.***

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Konispol për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

### ***c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:***

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionin nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023,
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

### ***d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.***

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin.* Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 5,436 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

#### **e. Paraqitja e gjetjeve kryesore.**

*Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:*

- Për vitin 2023, Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, sipas dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë procedurë tjetër në zbatim të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve, veprime të cilat kanë çuar në debitorë të pa arkëtuar, në vlerën 40,099,996 lekë.

- Bashkia Konispol ka detyrime të prapambetura nga faturat e palikujduara në vlerën 24,130,518 lekë, Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likuidimit të tyre, pra ku fatura e parë të likuidohet më parë.

-Nga verifikimi i ditarit të bankës u verifikuan blerje mallrash me vlerë 25,194,903 lekë për të cilat disponohet dokumentacioni hyrës i këtyre mallrave si urdhër furnizim hyrje dhe fletë hyrje në magazinë por nuk është kryer kontabilizimi në llogaritë e klasës 3 (Gjendje inventari qarkullues). Në llogaritë e klasës 3 gjatë vitit 2023 nuk janë kryer kontabilizimet për hyrjet e materialeve dhe mallrave.

-Në Bashkinë Konispol me VKM nr. 113, date 13.02.2013 janë transferuar 811 pasuri, me VKM Nr. 433, date 08.06.2016 janë transferuar 125 pasuri, me VKM Nr. 1108, date 30.12.2015 janë transferuar 4 pasuri. Nga pasuritë e transferuara 17 pasuri janë pajisur me çertifikatë pronësie, 225 pasuri janë të pajisura me çertifikatë përdorimi dhe 698 pasuri nuk janë pajisur me çertifikatë pronësie.

-Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Konispol nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si pasojë, inventari rezulton i papërditësuar.

#### **f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Konispol, si Drejtoria e Aseteve, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për një numër debitorësh prej 3,948 debitorë në vlerën 40,520,459 lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

- Kryetari i Bashkisë Konispol dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

-Drejtoria e Financës të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llogaritë e klasës 3 të Aktivit me qëllim paraqitjen e një pamje reale dhe raportimin e saktë të kësaj llogarie në Pasqyrat Financiare.

-Bashkia Konispol duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZVASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

## **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.**

### **OPINIONI I AUDITIMIT**

#### **I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2023:**

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Konispol për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2023 - 31.12.2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar me rezervë për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Konispol, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2023, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

#### **Baza për opinionin i modifikuar me rezervë:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga

subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 5,436 mijë lekë.

**Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:**

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2023, paraqiten si më poshtë: Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, trajtuar hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

-Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 412,500 lekë.

-Llogaria 7206 “Inventar i imët” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 25,040,153 lekë.

-Llogaria 26 “Aktivet Afatgjata Financiare” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 449,000 lekë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 434/1prot., datë 03.04.2024 “Auditim financiar në Bashkinë Konispol”, i ndryshuar nr. 434/2 prot., datë 29.04.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 08.04.2024 -10.05.2024, në subjektin Bashkia Konispol për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 - 31.12.2023, u krye “Auditim Financiar” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S.D, Përgjegjës grupi;
2. K.H, Auditues;

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.**

### **1. Objektivat dhe qëllimi**

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionin nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale,

në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Projektaporti i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Konispol.

## **2. Identifikimi i çështjes**

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazaë risku, duke saktësuar përpunshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Konispol, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Konispol.

## **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Kryetari i Bashkisë Konispol (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Konispol, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efijencë.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet

buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.<sup>1</sup>

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

#### **4. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Konispol në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Konispol është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

#### **5. Kriteret e vlerësimit**

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 15



menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik“.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064,

datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

## 6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përrputshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përrputshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

## 7. Metodot e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit.* Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

*Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **8. Dokumentimi i auditimit**

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të Projekt Raporti i auditimit, deri në datën 22.05.2023, sipas përcaktimeve ligjore nuk janë paraqitur kundërshtime nga subjekti Bashkia Konispol. Projekt Raporti i auditimit është

dërguar me shkresën nr. 434/3 prot ., datë 27.05.2024.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Konispol”

*1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:*

##### **Profili i Bashkisë Konispol**

Bashkia Konispol kufizohet në veri me Bashkinë Finiq, në perëndim me Bashkinë Sarandën dhe në jug me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Konispolit.

Kjo bashkia kë 3 njësi administrative si: NJA Xarrë, NJA Markat dhe NJA Konispol



##### **Të dhëna të përgjithshme**

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e re Konispol ka një popullsi prej 8245 banorësh ndërsa sipas regjistrimit civil ka 13737 banorë. Sipërfaqja e bashkisë së re është 221.88 km<sup>2</sup>. Densiteti i popullsisë është 37.1 banorë për kilometër katror ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 61.91 banorë/km<sup>2</sup>.

Bashkia Konispolit ka si aktivitete kryesore ekonomike bujqësinë dhe blegtorinë, si dhe tregtinë ndërkufitare me Greqinë. Një pjesë e popullsisë shërben në sektorin e transportit për qëllime turistike në Konispol ose për transportin ndërkufitar, ndërsa një pjesë e popullsisë kalon kufirin rregullisht për të punuar përkohësisht në zonat pranë kufirit në Greqi.

Bujqësia është e përqendruar te agrumet, ullinjtë dhe vreshtat, ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore për bagëtinë e imët.

Infrastruktura e zonës është sistemuar me ndërtimin e rrugëve lidhëse, si dhe me rrugën drejt pikës kufitare të Qafë-Botit.

Bashkia ka në territorin e saj një vijë bregdetare prej rreth 10 kilometra të gjatë e cila aktualisht është e pazhvilluar përreth “Kepit të Stillos”. Në këtë pjesë të bregdetit gjenden mes të tjerash “Ishulli i Tongos”, një shkëmb me sipërfaqe prej rreth 5 mijë metrash katrore pranë Gjirit të “Ftelias”, në kufi me Greqinë, si dhe Ishulli i “Stilit”, për të cilën bashkia nuk ka mundur të krijojë guida turistike për promovimin e zonës dhe sigurimin e të ardhurave në favor të buxhetit të Bashkisë Konispol.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;

b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;

c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;

ç) ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

d) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;

dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Konispol, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Konispol për periudhën e aktivitetit të vitit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

## **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit**

### **1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

1.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

1.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, raporti i tyre me shpenzimet e vitit sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve të FZHR dhe Ministrive të linjës etj,).

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;

2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;

3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;

4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;

5. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimin të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.

6. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;

7. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj.

### **1.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;**

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, u konstatua se nuk janë realizuar Fazat e përgatitjes si më poshtë:

1. Nuk është hartuar raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave i cili miratohet nga Këshilli i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 01.03.2022.
2. Nuk janë hartuar tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025 për çdo program, miratohen nga Këshilli i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 15 mars.
3. Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA 2023-2025 për çdo program, nga Titullari i institucionit nuk është miratuar Udhëzimi i Brendshëm për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe e shpërndan tek secili Drejtues i Ekipit të Menaxhimit të Programit (DEMP).
4. Nuk është hartuar udhëzimi i brendshëm për përgatitjen e PBA-së i cili përmban:
  - a. Listën e programeve buxhetore dhe përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve;
  - b. Tavanet Përgatitore të PBA 2023-2025 për çdo program, për tre vitet e ardhshme buxhetore.
  - c. Afate të detajuara për Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për përgatitjen e kërkesave të shpenzimeve sipas programeve të PBA-së 2023-2025;
5. Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP) nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Koordinatorit i GMS, brenda muajit prill 2022. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet.
6. Nga Sektorët e Bashkisë Konispol nuk janë hartuar kërkesat buxhetore të cilat duhen të dorëzohen tek koordinatori i GMS vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik.
7. Nga Kryetari i Bashkisë Konispol nuk është dërguar brenda datës 1 Qershor 2022, pranë MFE, Projektin dokumentin e PBA 2023-2025 të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
8. Nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk është paraqitur deri me datë 31 janar për miratim në këshill raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:
  - a) dy vitet para vitit buxhetor;
  - b) vitin buxhetor;
  - c) tre vitet e ardhshme buxhetore.Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën "ç" të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore, pikën 6 të nenit 34 në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore", në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1. Pika 6, pika 10, pika 33, pika 34, pika 29, shkronjat "a-h" të pikës 40 në Udhëzimin nr.23, datë 22.11.2016 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore".

## **1.2. Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.**

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës. Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet

(shitesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë. Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Sarandë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara. Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shitesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Konispol ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Vlorë. Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

*Planifikimi i buxhetit për vitin 2023, Bashkia Konispol.*

*000/Lekë*

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022				
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr.53 , datë , 27.12.2022	Buxheti shtesë	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar,	Buxheti shtesë	Pakësimi i Buxhetit	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
		Miratuar me VKB			Miratuar me VKB			
	1	2	1+2+3		4	5	6	4+5+6
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	68,067		68,067	Art. 600 Paga	71120	6830.103		77,950
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm (2021) dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2022	3,000		3000	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	11877	-53.544		11,823
Të ardhurat e veta të planifikuara për shpenzim për vitin 2022	71,067		71,067	Art.602 Shpenzime operative	58067	25798.654		83,865
<b>Total të ardhurat e veta</b>	71,067		71,067	Art. 603 Sponsorizime				
Të ardhura të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar	1000		1000	Art.604 Transferime korrente të brendshme	5500	-2500		3000
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike	0		0	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	3556			3556
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2023	66,460	19061	85521	Art. 230-231 Investime	44138	-11013.76		33124
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023	55,731		55731	Fondi Rezervë + Kontigjencës				
<b>Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit</b>	123,191	19,061	142252					
<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	194,258	19,061	213,318	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	194258			213,318

*Burimi: Bashkia Konispol, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.*

Miratimi i buxhetit i bashkisë Konispol për vitin 2023 është miratuar me vendim nr.53 prot., datë 27.12.2022 konfirmuar nga prefekti i qarkut Vlorë më shkresën nr.60/1 datë 20.01.2023. Rezulton se buxheti i bashkisë Konispol i vitit 2023 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 213,319 mijë lekë. nga auditimi konstatohet se, buxheti vjetor i vitit 2023, nuk është miratuar brenda datës 25.12.2022 por është miratuar me datë 27.12.2022.

Ndryshimet buxhetore për vitin 2023 listuar si më poshtë:

Nga auditimi i ndryshimeve të bëra në buxhet rezulton se gjatë vitit ka patur lëvizje, por nuk shoqërohen me relacion shpjegues dhe nuk ka një analizë se si ndikojnë ndryshimet në realizimin e objektivave të synuara të Bashkisë. Ndryshimet buxhetore paraqiten si vijon:

Me VKB nr.14 prot., datë 30.08.2023 është miratuar shtesa në buxhet sipas shkresës nr.12764 datë 10.07.2023, për alokimin e fondit, pet rritjen e pagave në zbatim te vendimit nr. 328 datë 31.05.2023 në vlerën 5,097 mijë lekë.

Me VKB nr.15 prot., datë 05.06.2023 është miratuar shtesa në buxhet për vlerën 2,314 mijë lekë.

Me VKB nr.23 prot., datë 31.10.2023 është shtuar burimi i financimit transfertë e pa kushtëzuar në vlerën 5,000 mijë lekë.

Me VKB nr.31 prot., datë 19.12.2023 është shtuar burimi i financimit transfertë e pa kushtëzuar në vlerën 8,964 mijë lekë.

### **1.3.Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Sarandë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Sarandë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2023, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

*Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2023*

*000/Lekë*

<b>Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Konispol, për vitin 2023, në lekë</b>						
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i shpenzimeve</b>	<b>Plani 2023</b>	<b>Fakti 2023</b>	<b>Realizimi në %</b>	<b>Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta</b>	<b>Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti</b>
1	Artikulli - 600 Paga	82,237	76,664	93%	11,859	64,805
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore & shend	12,375	11,129	90%	1,928	9,201
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	81,597	67,531	83%	15,065	52,466
4	Artikulli - 604 Transferta korrente te brendshme	4,919	1,918	39%	0	1,918
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndhima ekonomike dhe PAK)	52,551	46,521	89%	0	46,521
8	Artikulli – 231/231	96,230	92,150	96%	16,200	75,950
	<b>TOTAL viti 2023</b>	<b>330,050</b>	<b>295,914</b>	<b>89.6%</b>	<b>45,052</b>	<b>250,861</b>

*Burimi: Bashkia Konispol.*



Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2023 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 90%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 230-231 “Kapitale të Patrupëzuara/Kapitale të Trupëzuara”, duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë Transferta Korrente të Brendshme. Vihet re se për vitin 2023 art. (604) transfera korrente të brendshme paraqiten 39 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët. Përsa i përket vlerës së mbuluar nga të ardhurat e veta është 45,052 mijë osë në masën 15 % lekë dhe Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti është 250,861 lekë ose në masën 84%.

### **Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.**

*Buxheti sipas burimeve të financimit viti 2023.*

*000/Lekë*

Nr.	Emërtimi	Viti 2023						
		Plani fillim Viti Sipas VKB	Çelja në Thesarit sipas akt rakordimit	Fakti sipas aktrakordimit	Te ardh veta	Grand	Tran. Kusht. Funk Deleg.	Tra. Kush Per Investime.
1.	Paga (600)	71,120	82,378	76,664	11,859	60,908	3,897	
2.	Sigurime (601)	11,877	12,375	11,129	1,928	8,726	475	
3.	Shpenzime (602)	58,067	81,597	67,531	15,065	52,466		
4.	Shpenzime (604)	4,500	4,919	1,918			1,918	
5.	(604) F. Rezervë	1,000	52,551	46,521				
6.	Fondi Veçantë	3,556				65	46,456	
7.	Inv(230 +231)	44,138	96,230	92,150	16,200	15,201		60,749
	<b>Totali</b>	<b>194,258</b>	<b>330,050</b>	<b>295,914</b>	<b>45,052</b>	<b>137,367</b>	<b>174,244</b>	<b>60,749</b>

*Burimi: Bashkia Konispol.*

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transfera e kushtëzuar për funksionet e deleguara, në vlerën 174,244 mijë lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Konispol, ndjekur nga transfera e pakushtëzuar në vlerën 137,367 mijë lekë, nga transfera e kushtëzuar në vlerën 60,749 mijë lekë, nga të ardhurat e veta në vlerën 45,052 mijë lekë.

#### Transfera e kushtëzuar për funksionet e deleguara.

-Buxheti nga transfera e pakushtëzuar për vitin 2023 është realizuar në vlerën 174,244 mijë lekë, ose 58% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës Kushtëzuar për funksionet e deleguara, e zënë transfera për familje dhe individ, paga dhe fonde të shpenzuara për transferime korrente të brendshme.

#### Transfera e kushtëzuar për Investime.

-Buxheti nga transfera e kushtëzuar për investime për vitin 2023 është realizuar në vlerën 60,749 mijë lekë, ose 20.5 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për investime, e zënë shpenzimet për investime.

#### Transfera e pakushtëzuar.

-Buxheti nga transfera e pakushtëzuar për vitin 2023 është realizuar në vlerën 137,367 mijë lekë, ose 46 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

#### Të ardhurat e veta.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2023 është realizuar në vlerën 45,052 mijë lekë, ose 15 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga, investime dhe shpenzime operative.

#### Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Fondi rezervë është përdorur për shpërbllim dalje në pension për 2 punonjës me urdhër nr. 4 prot datë 31.01.2023 për punonjës K.H dhe me urdhër nr. 191 datë 17.07.2023 për punonjës P.S.

#### Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.

Fondi i emergjencës është përdorur sipas VKB nr. 30 datë 30.11.2023 për ndërhyrje rehabilituese si më poshtë:

- Dy Urat Janjar në vlerën 387,310 lekë.
- Ura e vogël Janjar në vlerën 331,400 lekë.
- Rruga hyrëse fshati Shalës në vlerën 1,200,000 lekë.

#### Realizimi i Investimeve.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur Sektori i Finances dhe Buxhetit konstatohet se , niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në vitin 2023, në masën 96 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave ku vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta është në vlerën 45,052 mijë lekë ose 15 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, që do të thotë se nga Bashkia Konispol në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura për investime , duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Konkretisht për Kapitale të Trupëzuara/Kapitale të Trupëzuara janë planifikuar në vlerën 96,230 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 92,150 mijë lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Neni 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 muhor në Këshillin Bashkiak.

Për vitin 2023 Raporti i monitorimit vjetor është dërguar me nr. 286 prot., datë 01.03.2024 pranë MFE. Nga auditimi konstatohet se nga ana Nëpunësit Autorizues të Bashkisë Konispol nuk është paraqitur pranë këshillit përkatës, raportet 4 (katër) mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve të udhëzimit të Ministrit të Financave për monitorimin e zbatimit të buxhetit. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44 , të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

#### 1.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Duke analizuar tabelën e mëposhtme dhe të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Finances dhe Buxhetit lidhur me detyrimet e prapambetura konstatohet se , detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2022, rezulton në vlerën 14,252,000 lekë, si rrjedhojë e detyrimeve të prapambetuara, detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 është në vlerën 10,788,153 lekë, dhe në total në fund të vitit 2023 rezultojnë detyrime të prapambetura në vlerën

25,040,153. Detyrimet gjatë vitit 2023 janë paguar por edhe janë krijuar detyrime të reja, në vijimësi të analizës, lidhur me situatën e krijuar, rezulton se, detyrimi për vlerën 8,817,725 lekë është një detyrim i cili është krijuar si investim i financuar nga ministritë e linjës për “Përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë në fshatrat e Bashkisë Konispol”. Për këtë investim janë bërë likujtime pjesore duke filluar nga viti i krijimit të detyrimit dhe duke e likujtuar vlerën e mbetur si detyrim brenda vitit 2023. Përsa i përket vlerës 4,138,000 lekë gjithashtu detyrim për investime është likujtuar gjatë viti 2023 me urdhër shpenzimin nr. 80 prot., datë 04.04.2023. Detyrimet për investime përkatësisht vlera 8,817,725 lekë dhe vlera 4,138,000 lekë nuk janë shkarkuar nga detyrimet e thesarit edhe pse janë likujtuar si detyrime. Vlera e detyrimeve trajtuar si më lart është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Konispol ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/Urdhër Shpenzim) që krijon detyrimin përkatës. Nga auditimi konstatohet se, në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, nuk janë marrë masat për të mbuluar më parë detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101.

Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2023.

DETYRIME E NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2022 (në lekë)	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023.	Total detyrime 31.12.2023
<b>A</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3=1+2</b>
INVESTIME	4,138,000	8,817,725	12,955,725
VENDIME GJYQËSORE	0	0	0
MALLRA DHE SHËRBIME	10,114,000	1,970,428	12,084,428
<b>TOTALI</b>	<b>14,252,000</b>	<b>10,788,153</b>	<b>25,040,153</b>

Burimi: Bashkia Konispol.

#### Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023:

Nga auditimi i pagesave të kryera dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Sarandë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2023, ky afat nuk është respektuar në 18 raste për vlerën 24,130,518 lekë, këto për shpenzime për investime, shërbime dhe mirëmbajtje. Nga auditimi konstatohet se, nga 18 fatura të pa likujduara, 9 fatuara për vlerën 3,883,160 lekë i përkasin detyrimit të financuar nga të ardhurat e veta, 4 fatura në vlerën 5,244,179 lekë i përkasin detyrimit të financuar nga transfertat e pa kushtëzuara, 1 faturë në vlerën 8,817,725 lekë i përket detyrimit për investime detyrim i krijuar nga ministritë e linjës, dhe vlera prej 6.318.251 lekë i përket detyrimit të krijuar nga të ardhurat + transfertat për 4 fatura të pa likujduara. Në totalin e faturave të pa likujduara, rezulton se vlera prej 101,104 lekë për investimin “Furnizim me Ujë” investim i financuar nga të ardhurat + transfertat, dhe vlera 165,498 për shërbime postare financuar nga transfertat nuk janë të raportuara në MFE. Sa i përket likujdimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likujdimit të tyre, pra ku fatura e parë të likujdohet më parë. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Të dhëna të hollësishme lidhur me faturat e pa likuiduara.

OBJEKTI	OPERATORI EKONOMIK	BURIMI I FINANCIMIT	DETYRIMI
FURNIZIMI ME UJE	U.SR	1+5	101,104
SHERBIME POSTARE	P.SR	1	165,498
DETYRIME TE VJETRA	H.k	5	58,700
	O.SH	5	30,000

	K.R	5	27,500
	K	5	950,368
	T.N	5	85,000
	S.H	5	160,000
	F.B	5	19,650
Kancelari	4.K	1	274,140
ENERGJI ELEKTRIKE	OS	1+5	3,922,225
DEPOZITIM MBETJESH	B.L	1+5	1,409,775
Varrezat Mursi	I	5	2,084,440
Furnizim me uje ne fshatrat e bashkise	M.S	6	8,817,725
Detyrime nga periudha te meparshme	DETYRIME TATIMORE	5	302,004
Materiale ndertimi	I	1	699,242
KARBURANT	L	1+5	885,147
Shkolla Shales	E.C	1	4,138,000
<b>TOTALI</b>			<b>24,130,518</b>

*Burimi: Bashkia Konispol, Drejtoria e Financës.*

### Vështirësia Financiare e Bashkisë Konispol.

Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2023, përcjellë në MFE me e-mailin e datës 28.02.2024, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Konispol ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën 16,222,428 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime kapitale, pasqyruar në tabelën më poshtë:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua afatgjatë</b>	<b>0</b>		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
<b>II</b>	<b>Detyrimet e prapambetura</b>	<b>16.222.428</b>		<b>8,89%</b>
<b>Llogaria ekonomike</b>	<b>Emërtimi</b>			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	4.617.284		
4864201	D.P.EneriElektirke	3.732.511		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	192.360		
4864400	Det.Prap. Investime	3.722.646		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	3.655.623		
4864900	Det.Prap.Te Tjera	0		
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	154.134		
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	0		
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	0		
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	147.870		
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>16.222.428</b>	<b>182.418.628</b>	<b>8,89%</b>

*Burimi: Bashkia Konispol.*

Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 8.89 %, shifër që e klasifikon Bashkinë Konispol në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë z. E.D, zj. O.E Drejtoreshë e Financës në cilësinë e nënpunësit zbatues, z. D.Ll Pergjegjes i Sektorit te finances dhe buxhetit.*

### **1.5. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.**

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023

Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2023.

Rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.

Rakordimet me agjentët tatimor.

Evidenca e planifikimit të të ardhurave.

Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.

Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.

Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në lidhje me çështjen e të ardhurave.

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:*

### **Struktura e Sektorit te Sherbimit ndaj taksapaguesve Bashkia Konispol.**

Për vitin 2023 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 48, datë 06.12.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Konispol dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2023”, ku përfshihet edhe strukturën e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas strukturës është e përbërë nga sektorë dhe në total ka 3 punonjës konkretisht 1 Përgjegjës Sektori dhe 2 inspektor për tatim taksa vendore të Bashkisë Konispol.

### **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Për vitin 2023 paketa Fiskale për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Konispol është miratuar me VKB-në nr. 47, datë 06.12.2022 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti me shkresë nr. 1190/1 prot., datë 22.12.2023. Referuar të dhënave të paraqitura nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Konispol për vitin 2023 janë realizuar në masën 62.5%, nga 64.220 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 40,147 mijë lekë. Po ti referohemi akt-rakordimit me thesarin kostatohet se fakti është në vlerën 33,729,447 lekë, në këtë rakordim nuk janë përfshirë Grandet dhe Taksa e regjistrimit të automjeteve te perdorura. Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk planifikohet vlerë për t’u arkëtuar,

megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime. Nga auditimi rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar, nga Sektorit të Sherbimit ndaj taksapaguesve nuk është hartuar regjistri i taksapaguesve privat dhe familjar. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton se, metodologjia e përdorur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Pra nuk është bërë parashikimi i të ardhurave për buxhetin, mbi bazën e të dhënave faktike mbi subjektet që i nënshtrohen sistemit fiskal lokal. Sektori i Shërbimit ndaj taksapaguesve nuk është bazuar në të dhënat që disponon dhe në realizimin e të ardhurave të krahasuara me vitet e mëparshme, ku të bëjë parashikimin për fondin e të ardhurave, duke nxjerrë konkluzione për masat që duhet të merren për përmirësimin e punës në të ardhmen. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 47, datë 06.12.2022 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti me shkresë nr. 1190/1 prot., datë 22.12.2023. Rregullore e brendshme nr. 01. Datë 05.01.2022 neni 44 Per Miratimin e Rregullores “Mbi Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative” *Struktura e taksave pasqyruar në kapitullin “Aneksë” konkretisht Aneksi nr. A1, bashkangjitur Raportit të Auditimit.*

#### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet**

Në auditimin e kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga ASHK, Dega Rajonale Sarandë, u konstatua se, për periudhën objekt auditimi (01.01.2023 – 31.12.2023), kanë paraqitur kërkesë për pajisje me vërtetim mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, gjithsej 14 persona për vlerë takse të llogaritur prej 291,770 lekë, nga e cila deri me datë 31.12.2023 kanë paguar detyrimet 14 persona me vlerë 291,770 lekë. Referuar periudhës përpara vitit 2023 rezulton se gjendja debitorë ngelet e pa ndryshuar. Pra nuk kanë paguar detyrimin 11 persona me vlerë 246,548 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol. Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Konispol, personat përgjegjës, nuk është bërë asnjë njoftim drejtuar ASHK Dega Sarandë, për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet nëse është marrë ose jo certifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” *Debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi pasqyruar në kapitullin “Aneksë” konkretisht Aneksi nr. A2, bashkangjitur Raportit të Auditimit.*

#### **Administrimi i taksave dhe tarifave vendore**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Konispol kryhet në programin Excel. Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullohet nga njësitet administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Konispol i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistruar në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe

tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve për të cilat mund të ketë gabimë në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Situata e lëvizjes së subjeteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Konispol bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

*Tabela nr. 1. Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2023.*

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të Periudhës
1	Biznes i vogël	2023	128	0	4	124
2	Biznes i madh	2023	8	0		8
	<b>TOTAL</b>		<b>136</b>			<b>132</b>

*Burimi: Bashkia Konispol.*

## **Menaxhimi i borxhit**

### *Subjektet Debitore*

Nga informacioni i paraqitur nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol dhe auditimi i tyre, u konstatua se gjendja e debitorëve sipas periudhave objekt auditimi është si vijon:

*Tabela nr.2*

Nr.	Emërtim i taksës/tarifës vendore	Kategoria e taksapaguesit		Nr. Debitorëve 2023	Çelja 01.01.2023	Detyrimi progresiv i debitorëve më 31.12.2023
		Privat	Familjar			
1	Taks ndërtesë		Familjar	978	3.955.558	5.184.591
2	Taks toke bujqësore		Familjar	1586	12.234.200	14.920.880
3	Debitor biznes i vogël	Biznes		46	4.381.593	4.241.065
4	Debitor biznesi i madh	Biznes		1	404.800	444.300
5	Debitor truall, pastrim, ndricim,		Familjar	1300	14.213.047	15.309.160
6	Debitorë e ALUIZNI-t			11	246.548	246.548
7	Tjera..toka bujqësore me qera			26	165.952	173.915
	<b>TOTALI</b>			<b>3,948</b>	<b>35,601,698</b>	<b>40,520,459</b>

*Burimi: Sektori i Taksave dhe tarifave vendore.*

*Tabela nr.3 Detyrim i krijuar gjatë vitit 2023.*

Shtesa 2023.	8,870,932
Pakësime 2023.	3,952,171
<b>Totali</b>	<b>4,918,761</b>

*Burimi: Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol.*

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, konstatohet se gjendja e debitorëve më 31.12.2022 është në shumën 35,601,698 lekë kjo për 3,948 subjekte/familje, ku debitorët familjarë zënë 87 % të totalit të debitorëve për vlerën

35,414,631 lekë , gjë e cila tregon se nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol nuk është punuar në drejtim të arkëtimit të tyre në zbatim të dispozitave ligjore dhe mundësive të gjetjes së rrugëve, me qëllim vjeljen e të ardhurave . Përsa i përket detyrimit të krijuar gjatë vitit 2023, rezulton në vlerën 4,918,761 lekë, ku janë shtuar debitorë në vlerën 8,870,932 lekë dhe janë paksuar për vlerën 3,952,171 lekë, në krahasim me vitin 2022, gjendja e debitorëve vjen në rritje në masën 12 %.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi menaxhimin e detyrimeve fiskale që subjektet fizik/juridik/shtetërore dhe abonentët familjarë kanë ndaj Bashkisë Konispol rezulton se:

- Detyrime për TNI nga ndërtime informale paraqiten për 11 subjekte në shumën 246,548 lekë.
- Detyrime subjekte fizik/juridik e shtetërore në shumën 4,685,365 lekë kjo për 47 subjekte ose 11.5 % e vlerës së debitorëve.

- Debitorët familjarë në një numër prej 3,864 familjarësh [araqiten në shumën 35,414,631 lekë.

- Debitorë për tokën bujqësore e dhënë me qera paraqitet për 26 subjekte në shumën 173,915 lekë.

Nga auditimi konstatohet se, për debitorët që nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, dhe debitorët për taksën e tokës bujqësore të dhënë me qera, taksa të cilat në total përbëjnë vlerën 420,463 lekë, është bërë kryqëzimi i informacionit me pasqyrat financiare ku rezulton se ky detyrim nuk është regjistruar në kontabilitet si vlerë debitorë. Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, sipas dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë procedurë tjetër në zbatim të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve, veprime të cilat kanë çuar në debitorë të pa arkëtuar, në vlerën 40,099,996 lekë detyrim ky i kontabilizuar, dhe vlera 420,463 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara e cila duhej regjistruar në kontabilitet dhe të kërkohej arkëtimin i saj. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94

### **Agjentët Tatimorë**

Për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agjentët tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Konispol (*brenda datës 5 të çdo muaji*), gjë e cila konstatohet nga fakti se në vitin 2023 nuk ka asnjë arkëtim.

Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Sarandë në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Konispol, paraqiten si vijon:

*Tabela nr.4. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Konispol*

D.R.SH.T Rrugor	Taksa e mjeteve	1,800	3.006
Z.V.R.P.P (ASHK)	Taks kalim pronësi	260	0

*Burimi: Bashkia Konispol*

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë mosrealizimi. Bashkia Konispol nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Për sa më sipër, Bashkia Konispol nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Konispol, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat



për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura.

Këto veprime janë në kundërshtim me Neni 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

### **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Në territorin e Bashkisë Konispol për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 3 subjekte. Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitet 2023.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve përkatësisht rezulton:

1. Subjekti L me përfaqësues ligjorë z. D.K, pajisur me autorizim nr. 01, datë 25.06.2020. Sipas të dhënave në dosjen përkatëse, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar në total vlera me konfermat datës 08.06.2020 dhe 27.07.2020. 2. Subjekti “H.” ShPK me përfaqësues ligjorë z. Th.H. , është pajisur me autorizim nr. 03, datë 07.10.2021. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar në total vlera me konfermat e datave datës 10.09.2021 dhe 04.12.2023. 3. Përsa i përket Subjektit “I.” ShPK me përfaqësues ligjorë z. P.I, nga të dhënat e dosjes, rezulton se subjekti është pajisur me autorizimin nr. 4, datë 10.05.2015 nga ish- Komuna Markat, pas këtij viti nuk është pajisur me autorizim të ri. Nga Sektori i taksave me shkresën nr. ekstra, i është bërë kërkesë për paisje me liçensë tregtimi të karburanteve, por nuk është bërë i munduar arkëtimi i vlerës prej 1,000,000 lekë, vlerë e cila konsiderohet mungesë të ardhurash në buxhet, si dhe lejimin e ushtrimit të aktivitet pa liçensë. Nga auditimi konstatohet se, nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 3 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë nga të cilët 1 subjekt nuk ka paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore duke sjellë efekt financiar me vlerë totale 1,000,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Konispol. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “Neni 20-Autorizimet pika 2. VKM nr. 344, Datë 19.4.2017 Për Disa Ndryshime Në VKM nr. 970, Datë 2.12.2015, neni 15.1 dhe neni 15.2

### **Mbi llogaritjen e Taksës së ndikimit në infrastrukturë.**

Për periudhën nën auditim, 01.01.2023 – 31.12.2023, nga Bashkia Konispol janë miratuar dy leje ndërtimi për të cilën është vjelë Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë. Referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 47, datë 06.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”, marrim informacionin se vlera e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, e shprehur në përqindje, është dy për qind.

1. Për lejen e ndërtimit me nr. aplikimi AN110420230044, miratuar me Vendim Nr. 425/4 Prot; datë 16.08.2023, në favor të zhvilluesve z. A.G dhe z. SH.G, me objekt “Objekt shërbimesh dhe hotelerie 2 kat + podrum” është paraqitur preventivi me vlerë 41,138,474.00 lekë. Nga ana e Bashkisë Konispol është kryer llogaritja e taksës me dy mënyra, si parashikohet në nenin 46 të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si rrjedhojë, në nenin 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar,

pika 1, marrim informacionin se: “Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.”.

Mënyra e parë, sipas preventivit të punimeve: 41,138,474.00 lekë \* 2% = 822,769.48 lekë

Mënyra e dytë, sipas vlerës në lekë të koston mesatare të ndërtimit për metër katror:

*Tabela nr.5*

Nr.	Kati	Sipërfaqe	Kosto e ndërtimit	Vlera e TNI	Vlera
1	Nëntokë	332.7	32,739 lekë7m <sup>2</sup>	2%	217,845.3 lekë
2	Mbitokë	675	32,739 lekë7m <sup>2</sup>	2%	441,976.5 lekë
<b>TOTALI</b>					<b>659,821.8 lekë</b>

Si përfundim, vlera më e lartë e TNI-së përftohet nga llogaritja me mënyrën e parë, sipas preventivit të punimeve. Llogaritja e TNI-së dhe vjelja e saj nga ana e Bashkisë Konispol janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore.

2. Për lejen e ndërtimit me nr. aplikimi AN230320230165, miratuar me Vendim Nr. 356/5 Prot; datë 11.05.2023, në favor të zhvilluesit z. A. R, me objekt “Shtesë 1 kat në objekt ekzistues 1 kat” është paraqitur preventivi me vlerë 1,931,701.00 lekë. Nga ana e Bashkisë Konispol është kryer llogaritja e taksës me dy mënyra, si parashikohet në nenin 46 të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si rrjedhojë, në nenin 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 1, marrim informacionin se: “Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.”.

Mënyra e parë, sipas preventivit të punimeve: 1,931,701.00 lekë \* 2% = 38,634.02 lekë

Mënyra e dytë, sipas vlerës në lekë të koston mesatare të ndërtimit për metër katror:

*Tabela nr.6*

Nr.	Kati	Sipërfaqe	Kosto e ndërtimit	Vlera e TNI	Vlera
1	Mbitokë	41.5	32,739 lekë7m <sup>2</sup>	2%	27,173.37 lekë

Si përfundim, vlera më e lartë e TNI-së përftohet nga llogaritja me mënyrën e parë, sipas preventivit të punimeve. Llogaritja e TNI-së dhe vjelja e saj nga ana e Bashkisë Konispol janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore.

### **Mbi dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor e kullosor.**

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e bashkisë për dhënien me qira të pasurive të institucionit të qeverisjes vendore dhe konkretisht kontratat e qirave të lidhura midis Bashkisë Konispol dhe shoqërive private të telefonisë celulare si “V. A” sh.a, dhe të shoqërisë “A.” (T.A) sh.a, për periudhën objekt auditimi, në lidhje me mënyrën e lidhjes së kontratave, të përcaktimit të tarifave, të arkëtimit të detyrimeve nga dhënia e objekteve të ndryshme me qira rezulton se nga ana e Bashkisë Konispol dhe ish Komunës Markat sot Njësi Administrative e Bashkisë Konispol, janë lidhur 4 kontrata qiraje të cilat paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

*Tabela nr.7*

Nr.	Emri Shoqërisë	AFATI	Detyrimi vjetor	Paguar	Detyrim lene nga klsh 2022	Detyrimi vjetor	Detyrim 31.12.2023
1	O. T.	11.6.2020–10.6.2022-10.06.2023	300,000	300,000	0	150,000	150,000
2	O. T.	27.3.2021 – 26.3.2022	400,000	400,000	0	-	
3	V. Alb	9.2019–9.2021-09.2022-09-2023	800,000	0	800,000	400,000	1,200,000
4	V. Alb	4.2019 – 6.2021-06-2022	675,000	0	675,000	-	675,000
	<b>Shuma</b>		<b>2,175,000</b>	<b>700,000</b>	<b>1,475,000</b>	<b>550,000</b>	<b>2,025,000</b>

*Burimi: Bashkia Konispol, Përpunuar nga grupi i auditimi.*

Nga të dhënat e pasqyrës, rezulton se jo të gjitha kompanitë kanë likuiduar detyrimet sipas kontratave të lidhura, ku nga kompania private “V.A” sh.a, nuk janë kryer rregullisht pagesat në masën 100%, duke evidentuar një të ardhura të munguar në shumën 1,875,000 lekë. Përsa i përket subjektit “O.T” ka lidhur kontratë qeraje për një afat (5) pesë vjecar duke filluar nga data 11.06.2018 deri në 10.06.2023 ku vlera e qirasë e përcaktuar në kontratë është 150,000. Nga verifikimi i pagesave për vitin 2023 konstatohet se, qiramarrësi “O.T” nuk ka likuiduar detyrimet kontraktuale të përcaktuara në kontratë konkretisht për vlerën 150,000 lekë. Në total detyrimi nga mos likuidimi i detyrimit për kontrat e qerasë është në vlerën 2,025,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol. Këto veprime janë në kundërshtim me Kontratën e qirasë me nr.123 Rep, nr.33/2 Kol, datë 02.02.2015.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Kryetari i Bashkisë z. O.D, Përgjegjes i Sektorit të Sherbimit ndaj taksapaguesve z. D.K, z. J.H Specialist i Sektorit të Sherbimit ndaj taksapaguesve.*

## **2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

2.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.

2.4. Verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale sa prej tyre janë me çertifikatë pronësie.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Bashkia Konispol” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Sarandë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.

Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

**Pasqyrat Financiare të Konsoliduara** të Bashkisë Konispol për vitin 2023 janë të nënshkruara nga z. E.D Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. O.E me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Sarandë në datë 08.04.2024, në kundërshtim me afatet e përcaktuara me ligj.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumatat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Konispol për aktivitetin ekonomiko- financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, nuk janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2023 nuk rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; **Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 1,929,735,808 lekë dhe për vitin 2023 është 1,903,615,616 lekë.**

**Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023:**

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

**Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Konispol në 31.12.2023, sipas formatit F1, është paraqitur më poshtë:**

**1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).**

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=1,813,913,043 lekë.**

- Aktivet 1,903,615,616 lekë
- Detyrimet 89,702,573 lekë
- Aktivet Neto 1,813,913,043 lekë

#### **Aktivitet afatshkurtra:**

Aktivitet afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **103,938,718 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 24,131,787 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 4,828,836 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 74,978,095 lekë

#### **Fondi i Konsoliduar:**

##### **Llogaria 101 “Teprica (Fondi I akumuluar/Deficit i akumuluar)**

Në llogarinë 101 është paraqitur në vlerën 1,804,505,735 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF2:** Detajet e nënrubrikës ‘Teprica’.

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zerat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	1,803,221,330	Çelje
Amortizim i vitit	90,866,096	92,150,501	Investime + Dhurime
		-	Ndryshim i gjendjes së inventarit
	90,866,096	1,895,371,831	
<b>Shuma</b>		<b>1,804,505,735</b>	

**Burimi:** Bashkia Konispol

Sipas tabëlës së mësipërme e përlllogaritur dhe sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” vlera e raportuar në bilanc kuadron sipas udhëzimeve përkatëse.

##### **Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:**

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 24,131,787 lekë, përbëhet nga gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 9,407,308 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 14,724,478 lekë.

Lëvizjet e klasës 5“Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”, paraqitet në **pasqyrën PF3** në anekset e projekt raportit.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 103,278,538 lekë dhe kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" dhe 466 "Mjete në ruajtje".

Fondet e papërdorura për vitin 2023 janë si më poshtë:

1-Trasferte e pakushtëzuar dhe specifike viti 2023 e papërdorur 2,774,133 lekë.

2-Të ardhurat viti 2023 të papërdorura 6,633,175 lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 9,407,308 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2023.

##### **Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Konispol në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 4,828,836,lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 407,957 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët ” në vlerën 4,420,879 lekë.

Gjendja e llogarive të mësipërme nuk është e kuadruar me gjendjen e inventarëve.Në llogaritë e klasës 3 gjatë vitit 2023 nuk janë kryer kontabilizimet për hyrjet e materialeve dhe mallrave të ndryshme në kundërshtim me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

dhe udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhiin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas ditarit të bankës u verifikuan 45 fatura tatimore me vlerë 25,194,903 lekë për të cilat nuk është kryer kontabilizimi në llogaritë e klasës 3 (Gjendje inventari qarkullues). Për faturat e mësipërme u kërkua dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të gjitha shpenzimet e mëposhtme disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

-Urdhër furnizim hyrje (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë hyrje në magazinë

-Urdhër furnizim shpërndarje sipas kërkesave (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë dalje nga magazine.

#### **Inventarizimi i aktiveve:**

Bashkia Konispol për vitin 2023 nuk ka kryer procedurën e inventarizimit të aktiveve, e cila shërben për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve dhe përdorimin me efikasitet të tyre. Gjatë vitit 2023, Bashkia Konispol në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, sistemi i kontrollit periodik të aktiveve pikat 73-80 për inventarizimin e aktiveve nga Titullari i Njësisë Publike nuk janë ngritur urdhrat për procesin e inventarizimit.

#### **Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme ”&“Të tjera aktive afatshkurtra”:**

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF5** në anekset e projekt raportit.

**Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”**, përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 35,189,198 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 40,099,459 lekë, me rritje për vlerën 4,910,261 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike.

Nga analiza e llogarisë 468 “**Debitorë të ndryshëm**” u vërtetua se Drejtoria e Financës nuk ka bërë kontabilizimin e detyrimeve nga të ardhurat për tokat bujqësore të dhëna me qera në vlerën 173,915 lekë dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën 246,548 lekë dhe detyrimet në vlerë 1,864,531 lekë të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas Vendimit të Kryetarit të dërguara në Bashkinë Konispol edhe pse kanë dalë urdhër zhdëmtimeve përkatëse, të dala nga Kryetari i Bashkisë sipas planit të veprimit.Veprime në kundërshtim me nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.

**Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 34,878,100 lekë dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është paraqitur në vlerën 9,837,947 lekë. Vlera prej 34,878,100 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF6:** Detajet e nënrubrikës “*Të tjera operacione me shtetin*”.

<b>Emërtimi i llogarive</b>	<b>Vlera</b>
Llogari 401-408	25,492,311
Paga personeli llog 42	5,398,677
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	411,148

Sigurime shoqërore llog.435	3,140,970
Sigurime shëndetësore llog.436	434,994
<b>Totali</b>	<b>34,878,100</b>

**Burimi:** Bashkia Konispol

Nga analiza e mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur saktë dhe kuadron me llogaritë e klasës 4.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” e cila është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 25,040,153 lekë në kundërshtim me udhëzimin Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Llogaritë e Marrëdhënieve me shtetin

Në marrëdhëniet e institucioneve me shtetin përdoren dy llogari specifike dhe karakteristike për sektorin publik buxhetor.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

**a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:**

Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “Shpenzime sipas natyrës”;

Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42,43,40,e të tjera).

**b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:**

Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;

Kreditohet llogaria 7206 ”Financim i pritshëm nga buxheti”.

**c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi:**

Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4);

Kreditohet llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”.

**d) Paralel me veprimin e mësipërm artikullohet veprimi tjetër:**

Debitohet llogaria 476” Të ardhura të caktuara për tu përdorur”;

56

Kreditohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

**Aktivitet Afatgjata jomateriale (AAJM)**

**Llogaritë e Klasës 20 “Aktivitet Afatgjata Jo materiale”,** përbëhen nga llog.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 6,108,601 lekë, amortizim të akumuluar në vlerën 6,108,601 lekë dhe vlerë neto 0 lekë. Nga verifikimi i rregjistrimit të prokurimeve për vitet 2021-2023 nuk ka pasur nga ana e Bashkisë Konispol blerje projektsh. Drejtoria e Financës nuk disponon rregjistër analitik për këtë llogari.

**Aktivitet e afatgjata materiale (AAM)**

**Llogaritë e Klasës 21 “Aktivitet Afatgjata Materiale”,** AAM sipas të dhënave të pasqyruara



për vitin ushtrimor 2023, paraqiten me tepricë neto 1,799,676,898 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,798,392,494 lekë. . Gjatë viti 2023 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 92,150,501 lekë shtesat kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje , në Bashkinë Konispol dhe NJ.A Administrative.Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2023 kanë qenë në vlerën 90,866,096 lekë. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF7:** Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale”.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2022	Shtesa 2023	Amortizim 2023	Pakësime 2023	Gjendja me 31.12.2023
210	Toka, Troje, Terrene	24,011,454	0	0	0	24,011,454
211	Pyje, Kullota, Plantacione	0	0	0	0	0
212	Ndërtime e Konstruksione	368,221,963	6,138,000	18,411,098	0	355,948,865
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,363,847,293	85,493,948	68,192,365	0	1,381,148,876
214	Instalime dhe paisje	27,998,154	0	1,399,908	0	26,598,247
215	Mjete Transporti	10,645,295	0	2,129,059	0	8,516,236
218	Inventar Ekonomik	3,668,334	518,553	733,667	0	3,453,220
	<b>Shuma</b>	<b>1,798,392,494</b>	<b>92,150,501</b>	<b>90,866,096</b>	<b>0</b>	<b>1,799,676,898</b>

**Burimi:** Bashkia Konispol

**1. Llogaria 210 “Toka, troje terrene”** është paraqitur në bilanc në vlerën 24,011,454 lekë.

Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik dhe gjithashtu në vlerën e saj nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Konispol dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative “Xarrë” dhe “Markat”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, pika 26.

**2. Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”**

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës këtë llogari ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

**3. Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”** cila pasqyron gjendjen 43 aseteve për llogari të Bashkisë Konispol, në fund të vitit 2022 rezulton me kosto historike 497,239,440 lekë dhe në fund të vitit 2023 rezulton me kosto historike 503,377,440 lekë.

Kjo rritje në vlerë vjen për shkak të kapitalizimit të investimet e kryera në vitin 2023.

Kapitalizimi për vitin 2023 është në vlerën 6,138,000 lekë për objektet si mëposhtë:

1-Godina e shkolles Xarrë (shtesa 4,138,000 lekë)

2-Varrezat fshati Mursi ( 2,000,000 lekë)

Amortizimi vjetor për këtë llogari ka qenë në vlerën 18,411,098 lekë.

Në pasqyrën e pozicionit financiar aktivet paraqiten me vlerë neto, llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” paraqitet me vlerë neto 355,948,865 lekë.

Llogaria 212 analitike “Ndërtesa dhe konstruksione”, paraqitet në **pasqyrën PF8** në anekset e Raportit të Auditimit.

**4. Llogaria 213 “ Rrugë,rrjete,vepra ujore”** cila pasqyron gjendjen 82 asetëve për llogari të Bashkisë Konispol, në fund të vitit 2022 rezulton me kosto historike 1,453,219,405 lekë dhe në fund të vitit 2023 rezulton me kosto historike 1,538,713,353 lekë.

Kjo rritje në vlerë vjen për shkak të kapitalizimit të investimet e kryera në vitin 2023. Kapitalizimi për vitin 2023 është në vlerën 85,493,948 lekë për objektet si mëposhtë:

1-Përmirësimi i infrastrukturës furnizim me uji fshatrat e Bashkisë Konispol (shtesa 58,638,642 lekë)

2-Ndriçim Publik (shtesa 6,713,234 lekë)

3-Shttrim me Asfaltobeton (20,142,072 lekë)

Amortizimi vjetor për këtë llogari ka qënë në vlerën 68,192,365 lekë.

Në pasqyrën e pozicionit financiar aktivet paraqiten me vlerë neto,llogaria 213 “Rrugë,rrjete,vepra ujore” paraqitet me vlerë neto 1,381,148,876 lekë.

Llogaria 213 analitike “Rrugë,rrjete,vepra ujore”, paraqitet në **pasqyrën PF9** në anekset e Raportit të Auditimit.

**5. Llogaria 215 “Mjete transporti”.** Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Konispol më datë 31.12.2022 paraqitet në shumën 29,321,424 lekë me vlerë historike, gjatë vitit 2023 kjo llogari nuk ka patur ndryshime paraqitet me të njëjtën vlerë.

Llogaria 215 e paraqitur në bilanc për vitin 2023 paraqitet me vlerë neto 8,516,236 lekë dhe përbëhet nga 16 mjete.Amortizimi vjetor i kësaj llogarie për vitin 2023 është në vlerën 2,129,059 lekë.

Llogaria 215 analitike “Mjete transporti”, paraqitet në **pasqyrën PF10** në anekset e Raportit të Auditimit.

**6. Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”.** Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Konispol. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Konispol gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet në vlerën 3,453,220 lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 218 “Inventari ekonomik” është ulur me vlerën 215,114 lekë.

<b>Lëvizjet Llog. 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2023, vlera në lekë</b>	
Çelje në 01.01.2023	3,668,334
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	518,553
Dalje 2023 (K)	733,667
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>3,453,220</b>

**Burimi:** Bashkia Konispol

**Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Konispol në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën(364,121,896 ) lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2023. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (90,866,097) lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2023.

Lëvizja e llogarisë 219“Amortizimi i AAGJM & AAJM”, paraqitet në **pasqyrën PF11** në anekset e Raportit të auditimit.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr 05 datë 21.02.2022 “Për

disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Konispol, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

### **Aktivet Afatgjata Financiare**

Aktive Afatgjata Financiare paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2022 dhe 2023 me vlerën 0 lekë.

-Bashkia Konispol në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 4.49% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Sarandë” sh.a me NUIS“M24828802U” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”.

Numri i aksioneve është 4,490 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 449,000 lekë.

Vlerat e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit në asnjë rast nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2023 ,më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesmarrje”.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 449,000 lekë dhe investori është Bashkia Konispol.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivët Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime ne Pjesmarrje me vlerë kontabël 449,000 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

### **Investimet:**

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Nga auditimi u verifikuar se kjo llogari është paraqitur e saktë. Bashkia Konispol nuk ka pasur gjatë vitit 2023 investime në proces. Investimi “Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë në fshatrat e Bashkisë Konispol” është kontabilizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 58,638,642 ky investim ka përfunduar dhe është kolauduar.

## **PASIVET (DETYRIMET)**

### **Pasivet Afatshkurtra**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Konispol më datë 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

**Pasqyra PF12: Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.**

Llogaritë		Viti 2023	Viti 2022	Diferenca
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	25,492,311	14,756,764	10,735,547
42	Detyrime ndaj personelit	5,398,677	5,531,627	(132,950)
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	411,148	332,680	(78,468)
435	Sigurime shoqërore	3,140,970	1,621,268	1,519,702
436	Sigurime shëndetsore	434,994	224,627	210,367
467	Kreditor të ndryshëm		43,364,552	(43,364,552)

**Burimi: Bashkia Konispol**

**Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”**, në fund të vitit 2023 është paraqitur në vlerën 25,492,311 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Konispol më 31.12.2023. Fatura të palikujduara të cilat kanë kaluar afatin 60 ditor janë në vlerën 24,130,518 lekë dhe përbëhen nga 18 fatura tatimore sipas tabelës si më poshtë.

Analiza e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në pasqyrën PF13 anekset e projekt raportit.

Nga auditimi i faturave të palikujduara në datë 31.12.2023 rezultoi se faturave e operatorit ekonomik “E C” me nipt L.....R me nr fat 100, datë 30.11.2019 është likuiduar sipas urdhër shpenzimi nr.80 datë 04.04.2023 me vlerë 4,138,000 lekë. Kjo faturë nuk është çrregjistruar akoma nga thesari dhe kontrata deri në fund të vitit 2023 ka vazhduar të jetë e pa mbyllur edhe pse është kryer total likuidimi për këtë kontratë.

Për objektin e prokurimit “Furnizim me ujë i fshatrave të Bashkisë Konispol” investim i vitit 2021 me vlerë kontrate me tvsh 98,338,609 lekë operatori ekonomik në fund të vitit 2023 paraqitur si kreditor me vlerën 8,817,725 lekë. Objekti i investimit ka përfunduar dhe është kolauduar. Sipas Pasqyrën PF 14 e paraqitur në anekset e Raportit të Auditimit e rakorduar me urdhër shpenzimet dhe faturat e dërguar nga operatori ekonomik M.S rezulton detyrim i palikujduara në shumën 1,000,000 lekë për këtë kontratë.

Gjendja reale e llogarisë 401-408 e cila duhej të paraqitej në pasqyrën e pozicionit financiar është në shumën 16,674,586 lekë duke zbritur shumën 8,817,725 lekë e cila është paguar për operatorët ekonomik E.dhe M.S. Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është rregjistruar në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore.

Fatura të palikujduara të cilat kanë kaluar afatin 60 ditor janë në vlerën 12,174,288 lekë dhe përbëhen nga 11 fatura tatimore.

Stoku i detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE është në vlerën 16,222,428 lekë dhe përbëhet nga 10 fatura tatimore.

Nga auditimi i llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” u vërtetua se fatura të palikujduara të cilat janë nuk janë likuiduar brenda 60 ditëve janë në vlerën 12,174,793 lekë.

**Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”**, sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Konispol, paraqitet në vlerën 5,398,677 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar ne muajin janar 2024 ne shumen 5,398,677 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën PF16 më poshtë.

Urdhër Shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
1	09.01.2024	Pagat dhjetor bashkia 2023	5,227,359
2	09.01.2024	Pagat dhjetor gjendja civile 2023	171,318
<b>Shuma</b>			<b>5,398,677</b>

**Burimi:** Bashkia Konispol

**Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 411,148 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar ne Janar 2024.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF17** më poshtë.

Urdher shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
5	11.01.2024	Tatim Page dhjetor	203,658
13	25.01.2024	Tatim Page nentor	201,460
Shuma			<b>405,118</b>

**Burimi:** Bashkia Konispol

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 3,140,970 lekë dhe 434,994 lekë.

**Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”**

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF18** më poshtë.

Urdher shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
4	11.01.2024	Sigurime Shoqërore 9.5% dhjetor	609,319
7	11.01.2024	Sigurime Shoqërore 15% dhjetor	957,101
12	23.01.2024	Sigurime Shoqërore 9.5% nentor	594,749
14	25.01.2024	Sigurime Shoqërore 15% nentor	934,105
Shuma			<b>3,095,274</b>

**Burimi:** Bashkia Konispol

**Llogaria 436 “Sigurime shëndetsore”**

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF19** më poshtë.

Urdher shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
6/8	11.01.2024	Sigurime Shëndetsore 1.7% dhjetor	216,940
15/17	25.01.2024	Sigurime Shëndetsore 1.7% nentor	211,726
Shuma			<b>428,666</b>

**Burimi:** Bashkia Konispol

**Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Konispol, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 14,724,478 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Sarandë.

Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, konstatohet se Drejtoria e Financës nuk disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, nuk jep informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende.

Analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” paraqitet në **pasqyrën PF20** në anekset e Raportit të Auditimit.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50, dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

### **Pasqyra e Performanës Financiare:**

**Analizë e llogarive** sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të paqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet **Pasqyrën PF21** në anekset e raportit të Auditimit.

**Analiza e llogarive të të ardhurave** për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 230,993,516 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Sarandë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 14,779,660 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 4,154 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 10,963,705 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 3,811,801 lekë e cila përfshin taksat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 19,012,787 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 2,347,760 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 16,665,027 lekë, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** pasqyrohet në vlerën 9,837,947 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” e cila paraqitet në vlerën 34,878,100 lekë.

**Analiza e llogarive të shpenzimeve** në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 205,386,411 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli”** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 77,337,683 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 77,337,683 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 “Kontribute për sigurime”** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 12,001,154 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 12,001,154 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 67,608,603 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 67,608,603 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 1,917,887 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 46,521,084 lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

**Per vitin 2023** totali i te ardhurave ne vlere është 222,461,428 lekë dhe totali shpenzimeve eshte 213,340,697 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 9,120,731 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

### **Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Konispol).**

#### **-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”**

**Për vitin 2023** numri i punonjësve është miratuar me VKB Nr.48 datë 06.12.2022. Miratuar në total numri 135 + 3 punonjësit të Gjendjes Civile = 138 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 123 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Konispol, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2023 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj.O.E dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari i Bashkisë; Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjëse i Burimeve Njerëzore z. E. H dhe nga Nenkryetarja e Bashkisë znj. K.S .

#### **Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2023.**

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2023) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga K.S Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Konispol, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Konispol, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2023)konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. O.E dhe nga specialistet e pagave.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës z. O.E dhe nga Kryetari Bashkisë z. E.D

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjëse i Burimeve Njerëzore z. E.H dhe nga Nenkryetarja e Bashkisë znj. K.S.

Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, janë bërë ndalesa edhe për debitorët të përcaktuar në Urdhrat përkatës. (Te vendosura nga Përmbartimi apo palë të tjera.)

Në bazë të urdhrit nr. 762/935, datë 26.12.2019 të Zyres Permbartimore R.B.S.

Eshte mbajtur vlera 12,000 lekë nga z.D.A çdo muaj.

Tabela e burimit të Financimit të pagave paraqitet në **Pasqyrën PF22** më poshtë:

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transferte specifike
Viti 2023	82,376	76,664	93	39,651	11,859	21,257	3,897

**Burimi:** Bashkia Konispol

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë paraqitet në **Pasqyrën PF23** më poshtë:

000/lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2023		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	82,376	76,664	93
2	F. Sig. Shoq	12,375	11,129	90

**Burimi:** Bashkia Konispol

### **Transaksionet financiare nëpërmjet thesarit.**

Grupi i Auditimit verifikoi në platformën elektronike të sistemit të prokurimit publik (SPE) në lidhje me procedurat e kryera gjatë vitit 2022 dhe 2023 në funksion të shpenzimeve të nevojshme për mundësimin e veprimtarisë së institucionit. Nga informacioni i marr nga ditari i bankës për shpenzimet e kryera gjatë vitit 2023 për blerje mallra dhe shërbime rezultoi se për 31 procedura me blerje të vogël me vlerë fature 25,194,903 lekë, vlerë urdhër shpenzimi 24,474,177 lekë dhe 1 procedurë blerje karburanti me vlerë fature 14,914,481 lekë dhe vlerë urdhër shpenzimi 14,029,334 Bashkia Konispol ka shmangur fushën e zbatimit të legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Referuar proceduralisht, zbatimi i ligjit për prokurimin publik përbën “një kusht të domosdoshëm” për kryerjen e shpenzimeve publike.

Kryerja e shpenzimeve duke shmangur fushën e zbatimit të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik ndikon negativisht në mirëpërdorim të fondeve, nisur nga fakti që në thelb vetë qëllimi i procedurave të prokurimit është të ulë vlerën e shpenzimeve të nevojshme.

**Ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 2, pika b, sipas të cilit:** “Qëllim i këtij ligji është të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”;

**Ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni , pika 2 sipas të cilit:** “Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën”.

Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi:

1-Sh.B (Ish-Kryetar i Bashkisë Konispol deri më 23.06.2023)

2-E.D (Kryetar i Bashkisë Konispol prej 23.06.2023)

3-O.E (Drejtor i Drejtorisë së Financës)

Lista analitike e faturave të likuajuara paraqitet në **Pasqyrën PF24** në anekset e Raportit të Auditimit.

Nga verifikimi sipas ditarit të bankës u verifikuan shpenzimet e mësipërme për të cilat u kërkua dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.



Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të gjitha shpenzimet e pasqyruara në **pasqyrën PF24** disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

-Urdhër furnizim hyrje (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë hyrje në magazinë

-Urdhër furnizim shpërndarje sipas kërkesave (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë dalje nga magazine.

Mallrat e mësipërm për të cilat është kryer blerja pa procedurë sipas dokumentacionin të vendosur në dispozicion, Grupit të Auditimit rezulton se janë marrë në dorëzim dhe kanë hyrë në magazine.

### **Likujdimi i Kontratës së Karburantit:**

Bashkia Konispol ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me Nr.1183 prot, datë 23.11.2021 me operatorin ekonomik të shpallur fitues në procedurën e prokurimit me ref-05047-09-12-2021.Kontrata e sipërmarrjes me objekt “blerje karburanti për automjetet e Bashkisë Konispol” është lidhur me vlerë kontrate 15,600,000 lekë me tvsh e cila do të financohet nga të ardhurat e Bashkisë Konispol.

Në **Pasqyrën PF25** në anekset e Raportit të Auditimit gjendet informacioni për faturat dhe urdhër shpenzimet për likujdimin e kontratës “Blerje Karburanti” me Ref-05047-09-12-2021.Sipas faturave të dërguara nga operatori ekonomik “L.” shpk vlera e e kontratës me tvsh është përmbushur me faturën nr.25/2022 datë 23.03.2022 dhe likujdimi i kontratës përfundimtar është likujduar sipas urdhër shpenzimit nr.36 datë 16.02.2023.

Gjatë vitit 2022,2023 janë pranuar nga ana e Bashkisë Konispol 11 fatura tatimore me objekt blerje karburantit me vlerë 14,914,481 lekë të cilat e kanë kaluar vlerë e kontratës së lidhur. Në **Pasqyrën PF26** në anekset e Raportit të auditimit gjendet informacioni për faturat e pranua dhe të likujduara gjatë vitit 2023 mbi vlerën e kontratës së realizuar.Gjatë viti 2023 nga faturat e pranua është likujduar shuma 14,029,334 lekë dhe ka mbetur për likujdim shuma 885,147 lekë.

### **ASETET E BASHKISË KONISPOL:**

Në zbatim të nënpikës 2.4 mbi “Menaxhimin e asetëve, inventari dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, të programit të auditimit nr.434/1 datë 03.04.2024, janë administruar evidencat si mëposhtë:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Konispol
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastër

### **I. PASURITË E PALUAJTSHME**

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin. Për bashkinë Konispol lista e pronave është miratuar me VKM e mëposhtme

-VKM nr. 113, date 13.02.2013 "Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen, ne pronesi ose ne perdorim, te Bashksie Konispol, të Qarkut të Vlorë"

-VKM nr. 433, date 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrimin të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave”.

- VKM nr. 1108, date 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkisë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të asetëve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”.

Nga totali prej rreth 940, pasuri që i janë transferuar Bashkisë Konispol, përfshirë pasuritë e paluajtshme të ish-komunave vetëm **17 pasuri janë certifikuar**.

Numri i pronave të transferuara me VKM paraqiteten në **Pasqyrën PF27** më poshtë:

Nr.		VKM		Pronesi	Në përdorim Në numër	Nga këto regjistruar
		Numër	Datë			
1	Bashkia Konispol	113	13.02.2013	586	225	0
2	Bashkia Konispol	433	08.06.2016	125	0	17
3	Bashkia Konispol	1108	30.12.2015	4	0	0
<b>Total</b>				<b>715</b>	<b>225</b>	<b>17</b>

**Burimi:** Bashkia Konispol

Lista e pronave të rregjistruara sipas objekteve dhe certifikatës së pronësisë paraqiteten në **Pasqyrën PF28** në anekset e Raportit të Auditimit.

Sipas kërkesave të VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive”, i janë kaluar në pronësi sipërfaqe:

Gjithsej **8,4229 ha**, nga këto:

- Pyje **3,114.5 ha**,
- Kullotë **6,765 ha**
- Toka joproductive **0 ha**,
- Shkëmbore dhe ujore **0 ha**,

Nga verifikimi i deritanishëm i evidencave, rezulton se:

Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Konispol nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se “*bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji*”.

### **3. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.**

3.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

3.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

3.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

*Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:*

- Shkresa përcjellëse nr.315/8, datë 25.07.2023 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës, protokolluar në zyrën e protokollit të Bashkisë Konispol, më datë 02.08.2023 me shkresën nr.804 prot.

- Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit.

- Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 6-muajsh) së bashku me raportin për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Konispol nuk ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar.

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Bashkia Konispol me shkresën nr.120 prot., datë 29.01.2024 ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor është zbatuar në afat.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, rezulton se:

Rregullorja e Brendshme nuk është plotësisht në përshtatje me strukturën organike aktuale, pasi mungojnë përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësi të Sektorit të Menaxhimit të Aseteve. Kështu në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Blegtorisë është shtuar pozicioni “*Inspektor për mbrojtjen e konsumatorit*” dhe në Drejtorinë Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit, janë shtuar pozicionet “*Specialist inxhinier hidroteknik*” dhe “*Sekretar i sekretarisë teknike*”, pozicione të cilat mungojnë në rregullore.

Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të Brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

“Menaxhimi i Riskut”

- Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut.

- Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut.

- Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.

- Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut.

- Nuk janë hartuar planet e veprimit për menaxhimin e riskut
- Nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.
- Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

#### “Aktivitetet e Kontrollit”

- Mungon sistemi i “IT” dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (BACK-UP)
- Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar “IT” të ndryshme në sektorë të ndryshëm, si dhe nuk ka plan investimesh për programet e “IT”. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

#### “Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit, nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

#### “Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përbushjen e objektivave mbi bazë impakt dhe produkti.
- Rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës, veprime në kundërshtim me ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8 pika 8 shkronja (d, e), Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, me atributet e Kryetarit të GMS, si dhe Nëpunësi Autorizues dhe Koordinatori i Riskut, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

1.1. Nga verifikimi rezultoi se, nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument lidhur me zbatimin e këtij Rekomandimi, në këto kushte rekomandimi mbetet i pa zbatuar.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi hartimin dhe funksionimin e strukturës organike të Bashkisë Konispol, nuk gjejmë të pasqyruar strukturën e Auditit të Brendshëm (AB), kjo për mungesë të specialistëve dhe nuk ka lidhur as aktmarrëveshje me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në

sektorin publik”, neni 10, shkronja (c), si dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, te VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja (a). (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.

### Menjëherë

2.1. Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Konispol nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e Rekomandimit 2.1. Rekomandimi nuk është zbatuar.

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se buxheti në fillim të vitit është planifikuar për vlerën 177,584 mijë lekë . Gjatë vitit buxheti është shtuar për vlerën 182,179 mijë lekë pra plani sipas thesarit është për vlerën gjithsej 359,763 mijë lekë, gjë që tregon se në planin fillestarë këto fonde nuk janë marrë në konsideratë, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet jo real, të qëndrueshëm dhe efektiv. Realizimi i buxhetit sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2022 nga 359,763 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 317,716 mijë lekë ose në masën 88 %, . Detyrimet e papaguara për vitin 2022 sipas bilancit janë në shumën 14,756,764 lekë ose në masën 6.48 % të shpenzimeve të planifikuara, ku peshën më të madhe e zënë detyrimet për energjinë elektrike, telefon pastrimin në vlerën 12,208,920 lekë ose 83 % e totalit. Për vitin 2022 nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetimit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42, me Udhëzimin e MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 33-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Konispol, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

### Në vijimësi

3.1. Nga verifikimi rezultoi se, buxheti për vitin 2023 është planifikuar në të njëjtin nivel të ardhurash duke mos i rritur ato, si rrjedhojë edhe të mos rritjes së nivelit të taksave vendore. Bashkia Konispol nuk ka marrë masat sikurse përcaktohet në rekomandimin 3.1. Në këto kushte rekomandimi mbetet i pa zbatuar.

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022, aktive për të cilat nuk është kryer inventar fizik, referuar Inventarit kontabël vlera 1,598,199 lekë që i përket gjendjes së aktiveve të kësaj llogarie në Aparatin e Bashkisë në vlerën 976,468 lekë, shkollat e Bashkisë Konispol në vlerën 336,193 lekë dhe NJA Xarrë në vlerën 285,538 lekë. Në gjendjen e llogarisë 32 **“Inventari i imët”** sipas inventarit kontabël të NJA Markat, e cila paraqitet në një vlerë sintetike prej 2,822,680 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo situatë është trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Konispol i bilancit të vitit 2015 të mbylljes së ish-komunës Konispol i paraqitur me probleme dhe pa analiza për këto aktive. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Drejtorisë Ekonomike të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llog. 32 “Inventari i imët” për shumën 4,420,879 lekë, të bëhet inventarizimi si dhe të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore mbështetur në UMF.

#### Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023

4.1. Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit 4.1. Rekomandimi nuk është zbatuar.

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 29,902,017 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 35,189,198 lekë, me rritje për vlerën 5,287,181 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike. Nga analiza e llogarisë 468 **“Debitorë të ndryshëm”** konstatohet se Drejtoria e Financës nuk ka bërë kontabilizimin e detyrimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas Vendimit të Kryetarit të dërguara në Bashkinë Konispol edhe pse kanë dalë urdhër zhdëmtimeve përkatëse, të dala nga Kryetari i Bashkisë sipas planit të veprimtimit. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrin masa për kontabilizimin e masave shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dërguar në Bashkinë Konispol me shkresat përkatëse.

#### Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023

5.1. Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financës nuk janë marrë në çdo rast masat për kontabilizimin e masave për shpërblimin e dëmit të rekoamnduar nga KLSH. Rekomandimi nuk është zbatuar.

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se llogarit 210 *“Toka, Troje, Terrene”*, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 24,011,454 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 24,011,454 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”* në mbyllje të vitit 2020 dhe vitit 2021 në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë, 211 *“Pyje, Plantacione”* paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)”* ,si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 0 lekë. Për këto vlerë nuk ka analiza dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu në vlerat e tyre nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Konispol dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative *“Xarrë”* dhe *“Markat”*. *Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogarit . 210 *“Toka, Troje, Terrene”* dhe 211 *“Pyje, Plantacione”* dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

#### **Menjëherë**

6.1. Nga verifikimi rezultoi se, nga strukturat e cituara në rekomandimin 6.1 nuk është marrë asnjë masë lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi Rekomandimi nuk është zbatuar.

**7. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 212 *“Ndërtesa Konstruksione”* paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 383,664,972 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 368,221,963 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)”* paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 497,239,440 lekë. Për këto AAGJM nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen së llog. 212 *“Ndërtesa”* është vlera kontabël e cila është e pa analizuar aktiv për aktiv. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Markat si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Konispol. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”* Kreu II *“Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”* pika 5, Kreu III. *“Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe*

konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Kryetari I Bashkisë Konispol, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksiione” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

#### Menjëherë

7.1. Nga verifikimi rezultoi se, nga strukturat e Bashkisë Konispol nuk është vënë në dispozicion dokumenti përkatës lidhur me zbatueshmërinë e këtij rekomandimi Rekomandimi nuk është zbatuar.

**8. Gjetje nga auditimi:** Referuar të dhënave për procedurat e zhvilluara për vitin 2022, gjithsej 5 procedura, me fond limit në vlerën 88,713 mijë lekë, mbi bazën e materialitetit u vlerësuan për aditim audituan 3 procedura me fond limit 30,564 mijë lekë, u konstatua se:

a- Në **3 procedura** raste me fond limit 30,564 mijë lekë, pasi kriteret e aplikuara janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe me tipologjinë e procedurës së zhvilluar, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura.

-Procedura me objekt “Zgjerim i varrezave të fshatit Mursi”, me vlerë të fondit limit 4,108 mijë lekë dhe vlerë kontrate 3,405 mijë lekë;

-Procedura me objekt “Rikonstrukcion i rrjetit të ndriçimit rrugor, Konispol”, me vlerë të fondit limit 8,917 mijë lekë dhe vlerë kontrate 7,678 mijë lekë;

-Procedura me objekt “Mbrojtje lumore në lumin “Pavëll” pranë urës së Bogazit”, me vlerë të fondit limit 17,539 mijë lekë dhe vlerë kontrate 14,153 mijë lekë;

b- Në **2 procedura** prokurimit, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DST dhe dispozitave të LPP. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte më të favorshme., konkretisht:

-Procedura me objekt “Rikonstrukcion i rrjetit të ndriçimit rrugor, Konispol”, me vlerë të fondit limit 8,917 mijë lekë dhe vlerë kontrate 7,678 mijë lekë;

-Procedura me objekt “Mbrojtje lumore në lumin “Pavëll” pranë urës së Bogazit”, me vlerë të fondit limit 17,539 mijë lekë dhe vlerë kontrate 14,153 mijë lekë; (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 61-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE. Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

**8.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga



autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik.

Nga verifikimi rezultoi se, nga strukturat e Bashkisë Konispol nuk është marrë asnjë masë për rekomandimet 8.1 dhe rekomandimin 8.2. Rekomandimi nuk është zbatuar.

#### Në vijimësi

**9. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2022 rezultoi se: Bashkia Konispol, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2022 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të U. K. Konispol SHA me NUIS “L.....V” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 299,600 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 299,600,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Konispol në “U.SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël të vitit 2022, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materialë” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.Rekomandimi:** Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “U.K Konispol Sh.a me vlerë 299,600,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

9.1. Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Konispol nuk është marrë asnjë masë për sistemimin në kontabilitet sipas përcaktimeve në rekoamndimin 9.1. Rekomandimi nuk është zbatuar

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, konstatohet se Drejtoria e Financës nuk disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, nuk jep informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende. Në pasqyrat financiare të vitit 2022 vlera e llogarisë 466 është në vlerën 16,373,031 lekë sipas aneksit nr. 7 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke

rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

10.1. Nga verifikimi rezultoi se, për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” janë kryer pagesa për disa subjekte. Pagesat janë kryer respektivisht për subjektet : K.Shpk me vlerë 500,001 lekë sipas urdhër shpenzimit nr.29 prot., datë 15.02.2023. K.Shpk me vlerë 1,930,212 lekë sipas urdhër shpenzimit nr.217 prot., datë 31.10.2023. Pagesat janë kryer për furnitorët: B.LL me vlerë 1,513,264 sipas urdhër shpenzimit nr.192 datë 21.09.2023. OSHE me vlerë 1,500,664 sipas urdhër shpenzimit nr. 270 prot., datë 28.12.2023. I. shpk me vlerë 942,486 lekë sipas urdhër shpenzimit nr.32 datë 15.02.2023. E. me vlerë 4,138,000 lekë sipas urdhër shpenzimit nr.80 prot., datë 04.04.2023. Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

**11. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agjentët tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Konispol (*brenda datës 5 të çdo muaji*), gjë e cila konstatohet nga fakti se në vitin 2022 nuk ka asnjë arkëtim. Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Sarandë në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhjet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo.

Për sa më sipër, Bashkia Konispol nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Konispol, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Neni 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1. Rekomandimi** Sektori i Shërbimeve tatimpaguese Bashkia Konispol, të marrë masa për:

- Evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizimin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatës dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

11.1. Nga verifikimi rezultoi se, ana e Sektori i Shërbimeve tatimpaguese Bashkia Konispol nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e kësaj rekomandimi. Rekomandimi nuk është zbatuar .

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se bashkia Konispol nuk ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve, dërguar nga KLSH-ja me shkresën nr. 257/6 prot, datë 31.5.2022, si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 21 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 21 masa. Nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa, janë në proces zbatimi 2 masa janë zbatuar pjesërisht 2 masa si dhe nuk janë zbatuar 10 masa organizative.

- Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa me vlerë **3,346,309 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga vlera e pranuar është arkëtuar vlera **500,000 lekë** nga subjekti L.SH si dhe nuk është arkëtuar vlera **2,846,309 lekë** për të cilat bashkia Konispol ka njoftuar subjektet që janë debitorë.

- Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-ve janë rekomanduar gjithsej **2 masa** me vlerë **1,190 mijë** lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht dhe nuk është zbatuar 1 masa me vlerë **1,190 mijë** lekë.

- Për masa disiplinore, është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Konispol ti Komisionit Disiplinor, marrja e masave ligjore e procedurale për fillimin ose jo të procedurave disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” masë e cila nuk është zbatuar nga subjekti.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 76-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1.Rekomandimi** Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa për përshpejtimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 257/6 prot datë 31.5.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Konispol”, respektivisht:

12.1. Nga verifikimi rezulton se nga, ana e Bashkisë Konispol nuk janë marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara akoma, apo zbatuar pjesërisht. Përsa i përket masave për shpërblim dëmi për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga subjekti “L-D” është bërë i mundur arkëtimi i detyrimit të në vlerën 757,778 lekë. Subjekti H.Shpk ka shlyer detyrimin total ndaj Bashkisë Konispol nëpërmjet bankës në datën 04.12.2023. Rekomandimi është në proces zbatimi. Për 10 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara dhe 2 masa organizative të zbatuara pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, në cilësinë e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut, të marrë masa për:

- Hartimin e Rregullores së re, e cila të jetë në përshatje me strukturën organike të miratuar për vitin 2021, duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë për pozicionet e reja, si pjesë e organigramës aktuale dhe përcaktimin e linjave të raportimit. Të përcaktohen rastet për parandalimin e konfliktit të interesit dhe procedurat e antikorrupsion.

- Hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

- Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve, realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt, si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.

**3.3 Rekomandimi:** Drejtoria e Financë Buxhetit Bashkia Konispol, të marra masa për përgatitjen e raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe krahas tyre për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen në fund të vitit 2021 të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale 43,364 mijë lekë, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë Buxhet Bashkia Konispol, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshirë kufizimet e transfertave specifike nga Ministritë e linjës dhe donator të ndryshëm), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

**7.1. Rekomandimi:** Bashkia Konispol, të marrë masa dhe të krijojë komisionin për marrjen në dorëzim të aseteve jo nën administrim, duke hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim të pronave, i cili duhet të nënshkruhet nga dorëzuesi i pronës dhe përfituesi (Bashkia Konispol), si dhe duhet të shoqërohet me tregues dhe element teknikë si harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre etj.

**7.2. Rekomandimi:** Bashkia Konispol, të marrë masa për evidentimin e pronave të ish- Bashkisë Konispol dhe 2 Njësi Administrative, Xarrë dhe Markat, të kryej inventarizimin, vlerësimin, kontabilizimin, pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme të pasqyrave financiare dhe të marrë masa për regjistrimin e të gjitha aseteve në ASHK Dega Sarandë.

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol të kërkojë në Këshillin Bashkiak, një ndryshim të strukturës organizative të bashkisë, duke krijuar Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe pronës publike, pjesë përbërëse e të cilës duhet të jenë Sektori i Bujqësisë dhe Sektori i Pyjeve e Kullotave.

**10.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrijë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nëpërmjet Drejtorisë Financë/Buxhet të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**11.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrijë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**12.1 Rekomandimi:** Drejtoria Financës në Bashkinë Konispol të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet t'i evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e

AQT” deri në vlerë të plotë, dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave të kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

**13.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 97/7, datë 17.6.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Konispol”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, respektivisht për:

- **20 masa** organizative, ku 5 prej tyre nuk janë zbatuar fare;
- **5 masa** shpërblim dëmi me vlerë **2,780,194 lekë**.
- **3 masa** shpenzime në kundërshtim me 3-E për vlerën 31,756,448 lekë;
- **4 masa** disiplinore.

**13.2 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Për 2 masa shpërblim dëmi në vlerë 2,846,309 lekë për të cilat Bashkia Konispol ka njoftuar subjektet që janë debitorë, të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë/Buxhet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **1,346,309 lekë**, respektivisht:

- **vlera 757,778 lekë**, ndaj zhvilluesit “**L-D**” shpk;
- **vlera 588,531 lekë**, ndaj zhvilluesit “**A.H**”.

**2.1. Rekomandimi:** Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **1,500,000 lekë** nga 2 subjektet, respektivisht;

- **vlera 500,000 lekë** nga subjekti “**H**.” ShPK;
- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti “**I**.” ShPK.

Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektorati Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Për 1 masa në shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E në vlerë 1,190 mijë lekë, e cila është konsideruar e pazbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E) me vlerë 1,190 mijë lekë.

**Menjëherë**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga Titullari i njësisë

**publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **276,684 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se me procesverbal nr. 06.01.2023, datë 25.8.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, me PV datë 16.01.2023 nga KVO është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, ku në fund KVO ka vendosur kualifikimin e të dy OE, duke shpallur fitues shoqërinë J shpk me ofertë 13,834,205 lekë pa TVSh me ofertë më leverdishme. me datë 18.01.2023 është bërë njoftim klasifikimi dhe ngarkuar në sistemin njoftimi i fituesit në zbatim të nenit 32, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021. Pas publikimit në APP të njoftimit paraprak të fituesit dhe në pritje së afateve të ankimit OE J shpk është tërhequr nga oferta nëpërmjet një mesazhit në sistemin datë 28.01.2023. Nga Bashkia Konispol (Sektori i prokurimeve dhe financës), nuk është vepruar për konfiskimin e sigurimit të ofertës, veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e bashkisë për shumën **276,684 lekë** (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 61-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e sigurimit të ofertës në vlerën **276,684 lekë**.

**Menjëherë**

1.1. Nga verifikimi rezultoi se, nga Drejtorisë së Financë/Buxhet nuk janë marrë masat e nevojshme lidhur me zbatueshmërinë e këtij rekomandimi. Rekomandimi nuk është zbatuar.

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga ASHK, Dega Rajonale Sarandë, u konstatua se.

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2022 – 31.12.2022), kanë paraqitur kërkesë për pajisje me vërtetim mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, gjithsej **7** persona për vlerë takse të llogaritur prej 195,900 lekë, nga e cila deri me datë 31.12.2022 kanë paguar detyrimet 7 persona me vlerë 195,900 lekë. Referuar periudhës përpara vitit 2022 rezulton se gjendja debitorë ngelet e pa ndryshuar. Pra nuk kanë paguar detyrimin **11** persona me vlerë **246,548 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Konispol. Paraqitet sipas aneksit nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Konispol, personat përgjegjës, nuk është bërë asnjë njoftim drejtuar ASHK Dega Sarandë, për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet nëse është marrë ose jo certifikatë pronësie. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, neni 23, pika 2/1 e nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **246,548 lekë** ndajë **11 personave**.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

1.1. Nga verifikimi rezultoi se, është ndjekur vetëm procedura e dërgimit të njoftimit tek debitorët lidhur me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Rekomandimi konsiderohet zbatuar pjesërisht.

**2. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit, u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (*sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas*), në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Në këtë njësi vendore operojnë tre subjekte të tregtimit të karburanteve, *respektivisht:*

1. Subjekti “L” ShPK me përfaqësues ligjorë z. D.K, pajisur me autorizim nr. 01, datë 25.6.2020. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar vlera prej 1,000,000 lekë (konferma datë 8.6.2020 dhe 27.07.2020).

2. Subjekti “H” ShPK me përfaqësues ligjorë z. Th. H, është pajisur me autorizim nr. 03, datë 7.10.2021. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar vlera prej 500,000 lekë (konferma datë 10.9.2021), **duke mbetur për detyrim shuma prej 500,000 lekë, si mungesë të ardhurash.**

3. Subjekti “I” ShPK me përfaqësues ligjorë z. P. I. Nga të dhënat e dosjes, rezulton se subjekti ka autorizim nr. 4, datë 10.5.2015 nga ish- Komuna Markat nuk është pajisur me autorizim të ri. Nga Sektori i taksave me shkresën nr. *ekstra*, i është bërë kërkesë për pajisje me licencë tregtimi të karburanteve, por nuk është bërë i mundur arkëtimi i vlerës prej 1,000,000 lekë, **vlerë e cila konsiderohet mungesë të ardhurash në buxhet, si dhe lejimin e ushtrimit të aktivitet pa licencë.**

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 ndryshuar me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 75-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1.Rekomandimi** Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,500,000 lekë** nga 2 subjektet, *respektivisht;*

- **vlera 500,000 lekë** nga subjekti “H.” ShPK;

- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti “I.” ShPK.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

2.1.Nga verifikimi rezultoi se Subjekti H. Shpk ka shlyer detyrimin total ndaj Bashkisë Konispol nëpërmjet bankës në datën 04.12.2023, ndërsa subjekti “I” Shpk rezulton debitor për vlerën e kërkuar në rekomandim. Rekomandimi zbatuar pjesërisht.

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e bashkisë për dhënie me qira të pasurive të institucionit të qeverisjes vendore dhe konkretisht kontratat e qirave të lidhura midis Bashkisë Konispol dhe shoqërive private të telefonisë celulare si “V.Albania” sh.a, dhe të shoqërisë “A” (T.A) sh.a, për periudhën objekt auditimi, në lidhje me mënyrën e lidhjes së kontratave, të përcaktimit të tarifave, të arkëtimin të detyrimeve nga dhënia e objekteve të

ndryshme me qira rezulton se nga ana e Bashkisë Konispol dhe ish Komunës Markat sot Njësi Administrative e Bashkisë Konispol, janë lidhur 3 kontrata qiraje, rezulton se jo të gjitha kompanitë kanë likuaduar detyrimet sipas kontratave të lidhura, ku kompania private V, nuk janë kryer rregullisht pagesat në masën 100%, duke evidentuar një të **ardhura të munguar në shumën 1,475,000 lekë nga kompania “V. Albania”**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e qirasë nr.123 Rep, nr.33/3 Kol, datë 02.02.2015. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 75-76 të Raportit të Auditimit)*.

**3.1.Rekomandimi;** Sektori Shërbimeve Tatimpaguesve Bashkia Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktual të palikujduara nga shoqëria “V.” në vlerën **1,475,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë**.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

3.1. Nga verifikimi rezultoi se, nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi, nuk është ndjekur asnjë rrugë ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktual. Rekomandimi nuk është zbatuar.

### **D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga informacioni i paraqitur nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol dhe auditimi i tyre, u konstatua se gjendja e debitorëve sipas periudhave objekt auditimi është si vijon: Gjendja e debitorëve më 31.12.2021 është në shumën 29,902,017 lekë kjo për 1707 subjekte/familje, ku debitorët familjarë zënë 86.2% të totalit të debitorëve, gjë e cila tregon se nga Zyra e taksave Konispol nuk punohet në drejtim të arkëtimit të tyre në zbatim të dispozitave ligjore dhe mundësive të gjetjes së rrugëve, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Konispol.

Në krahasim me vitin 2021, gjendja e debitorëve vjen në rritje, ku në fund të vitit 2021 vjen në vlerën 29,901,987 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 35,189,198 lekë **ose me rritje në vlerën 5,287,211 lekë**.

Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, sipas dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë procedurë tjetër në zbatim të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve, **veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhura për Bashkinë Konispol, në vlerën 35,189,198 lekë për vitin 2022**.

Gjithashtu, nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve nuk është vijuar me procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, ku rezultojnë se **48** subjekte debitorë (fizik/juridik) me vlerë **4,786,393 lekë**, janë debitorë në vite. Në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**1.1. Rekomandimi:** Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e



detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **35,189,198 lekë**, si më poshtë vijon:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Sarandë për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi.**

1.1.Nga verifikimi rezultoi se ,vlera e detyrimit të pa arkëtuar është e evidentuar për Bashkinë Konispol, debitorët janë njoftuar vetëm me njoftim vlerësime, nuk është vijuar me hapat e mëtejshme ligjore sikurse përcaktohet në rekomandimin 1.1. Rekomandimi mbetet i Pa zbatuar.

### **E. MASA DISIPLINORE**

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Konispol, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05/03/2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale, respektivisht:

**1. Z. A. B** me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit.

**2. Znj. M.H** me detyrë Specialiste Juriste.

**3. Z. D. K** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit të Tatimpaguesve.

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *“Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”* dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *konkretisht në praktikar:*

- “Zgjerim i varrezave të fshatit Mursi”, me fond limit 4,107,687 lekë.

- “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugorë, Konispol”, me fond limit 8,917,090 lekë.

- “Mbrojtja lumore në lumin Pavell-pranë urës së Bogazut”, me fond limit 17,539,343 lekë.

**4. Z. D. LL** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit.

**5. Z. L.B** me detyrë Specialist Inxhinier Ndërtimi.

**Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, *konkretisht në praktikat:*  
- “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugorë, Konispol”, me fond limit 8,917,090 lekë.  
- “Mbrojtja lumore në lumin Pavell-pranë urës së Bogazut”, me fond limit 17,539,343 lekë.  
Nga verifikimi rezulton se Nuk është ngritur Komisioni Disiplinor për verifikimin rast pas rasti të konstatimeve të KLSH-së.

**F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Konispol, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se bashkia Konispol nuk ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve, dërguar nga KLSH-ja me shkresën nr. 315/8 prot, datë 25.07.2023, si më poshtë vijon:

**a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar:** 13 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 13 rekomandime në masën 100 %. Nga të pranuarat, janë në proces zbatimi 0 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë, si dhe nuk janë zbatuar 12 masa organizative.

**b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar:** 1 masa me vlerë 276,684 lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht në masën 100 %. Nga verifikimi rezulton se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**c.** Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara , janë rekomanduar gjithsej 3 masa me vlerë 3,221,548 lekë dhe janë pranuar në masën 100%. Nuk janë zbatuar 3 masa me vlerë 2,721,548 lekë. Nga vlera totale është arkëtuar vlera 500,000 lekë.

**d.** Masa për uljen e borxhit tatimor është rekomanduar :1 masë me vlerë 35,189,198 lekë nga të cilat janë pranuar në masën 100 % dhe nuk është zbatuar 1 masë me vlerë 35,189,198 lekë.

e. *Për masa disiplinore janë rekomanduar* Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Konispol, ***për fillimin ose jo*** të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05/03/2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma j; Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

### **Nga sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH-së, rikërkon si më poshtë vijon:**

#### **A.Masa Organizative.**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, me atributet e Kryetarit të GMS, si dhe Nëpunësi Autorizues dhe Koordinatori i Riskut, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësisimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Konispol, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

**4.1.Rekomandimi:** Drejtorisë Ekonomike të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llog. 32 “*Inventari i imët*” për shumën 4,420,879 lekë, të bëhet inventarizimi si dhe të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore mbështetur në UMF.

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financë të marrin masa për kontabilizimin e masave shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dërguar në Bashkinë Konispol me shkresat përkatëse.

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogarit . 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe 211 “*Pyje, Plantacione*” dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**7.1.Rekomandimi:** Kryetari I Bashkisë Konispol, të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrëjë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE. Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

**8.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik.

**9.1.Rekomandimi:** Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjellës Kanalizime Konispol Sh.a me vlerë 299,600,000 lekë, në debi të llog. 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**10.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete nën ruajtje*”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**11.1. Rekomandimi** Sektori i Shërbimeve tatimpaguese Bashkia Konispol, të marrë masa për:  
- Evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizimin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

## **B. Masa Shpërblim Dëmi**

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e sigurimit të ofertës në vlerën **276,684 lekë**.

**C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara.**

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **246,548 lekë** ndaj **11 personave**.

**2.1.Rekomandimi:** Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,500,000 lekë** nga 2 subjektet, *respektivisht*;

- **vlera 500,000 lekë** nga subjekti "H." ShPK;

- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti I

**3.1.Rekomandimi:**Sektori Shërbimeve Tatimpaguesve Bashkia Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktual të palikujduara nga shoqëria "V." në vlerën **1,475,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.**

## **D. Masa për uljen e borxhit tatimor**

**1.1. Rekomandimi:** Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **35,189,198 lekë, si më poshtë vijon:**

*a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.*

**e-** Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Sarandë për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

**f-** Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

## **4.TË NDRYSHME TË DALA GJATË AUDITIMIT.**

**- Kontrata të lidhura nga FSHZH për blerje materiale:**

Gjatë vitit 2023 Fondi Shqiptar ka Zhvillimit ka realizuar disa procedura prokurimi marrëveshje kuadër për Bashkinë Konispol.

Marrëveshjet e lidhura nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me operatorët fitues paraqitëten në **Pasqyrën PF29** në anekset e Raportit të Auditimit.

**Lidhja e Kontratës:**

Bashkia Konispol më datë 21.11.2022 ka lidhur marrëveshjen e furnizimit me Fondin Shqiptar të Zhvillimit me objekt “ Mbështetje me furnizim me materiale ndërtimi me lëndë të parë, për realizimin e punimeve për projektet”,

1-Rikonstrukcion i qendrës së fshatit Dishat.

2-Rikonstrukcion i sheshit qendror të fshatit Markat.

Sëbashku me aplikimin e Bashkisë Konispol gjendet edhe preventivi përkatës për këto projekte.

1-Midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Operatorit Fitues për procedurën “Blerje Materiale mobilimi urban sipas kërkesave të Bashkive” është lidhur kontrata në zbatim të marrëveshjes kuadër Nr.2349/2022, nga kjo marrëveshje sipas projektit të miratuar Bashkia Konispol do të jetë përfituese e 22 stolave me krahë gize me përmasa 150\*60\*75.

2-Midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Operatorit Fitues për procedurën “Blerje Materiale elektrike sipas kërkesave të Bashkive” është lidhur kontrata në zbatim të marrëveshjes kuadër Nr.2347/2022, nga kjo marrëveshje sipas projektit të miratuar Bashkia Konispol do të jetë përfituese e materialeve sipas **Pasqyrën PF30 paraqitur në kapitullin Anekse bashkëlidhur Raportit të Auditimit.**

**3-Për Marrëveshjen Kuadër nr. 3108 Prot., datë 11.10.2022 me objekt: “Loti 1 - Blerje materiale ndërtimi sipas kërkesave të Bashkive nuk disponohet dokumentacion nga Bashkia Konispol si marrëveshja e furnizimit dhe marrëveshje e lidhur midis FSHZH dhe operatorit fitues.**

#### **Ngritja e Komisionit:**

Me urdhër Nr.1317 prot, datë 06.12.2022 të Titullarit të Bashkisë Konispol për marrjen në dorëzim të materialeve të ndërtimit nga FSHZH sipas marrëveshjes së datës 21/11/2022 është ngritur grupi i punës me përbërje znj.T. Ç, z.D. Ll, z.P.S.

#### **Marrja në dorëzim e Mallrave:**

**1-Sipas marrëveshjes së furnizimit të lidhur midis Bashkisë Konispol dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit në datë 21.11.2022 me objekt “ Mbështetje me furnizim me materiale ndërtimi me lëndë të parë për realizimin e objekteve 1-Rikonstrukcion i qendrës së fshatit Dishat dhe Rikonstrukcion i sheshit Qendror në fshatin Markat” nga grupi i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbale për marrjen e mallrave sipas specifikimeve teknike.**

Procesverbali i datës 09.12.2022 është firmosur nga grupi marrjes në dorëzim , nga përfaqësuesi i FSHZH dhe nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik.

**2- Sipas marrëveshjes së furnizimit të lidhur midis Bashkisë Konispol dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit në datë 21.11.2022 me objekt “ Mbështetje me furnizim me materiale ndërtimi me lëndë të parë për realizimin e objekteve 1-Rikonstrukcion i qendrës së fshatit Dishat dhe Rikonstrukcion i sheshit Qendror në fshatin Markat” nga grupi i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbale për marrjen e mallrave sipas specifikimeve teknike.**

Procesverbali i datës 28.12.2022 është firmosur nga grupi marrjes në dorëzim , nga përfaqësuesi i FSHZH dhe nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik.

**3- Për Marrëveshjen Kuadër nr. 3108 Prot., datë 11.10.2022 me objekt: “Loti 1 - Blerje materiale ndërtimi sipas kërkesave të Bashkive” nga grupi i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbale për marrjen e mallrave sipas specifikimeve teknike.**

Procesverbali i datës 22.12.2022 është firmosur nga grupi marrjes në dorëzim , nga përfaqësuesi i FSHZH dhe nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik.

#### **Magazinimi dhe dalja e materialeve:**

Drejtoria e Financës sëbashku me magazinën nuk ka dokumentuar hryjen dhe daljen e materialeve të marra në dorëzim me fletë-hyrje dhe fletë-dalje në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë

27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 42-50 marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara.

#### **IV. REKOMANDIME**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, u konstatua se:

- Nuk është hartuar raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave.
- Nuk janë hartuar tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025 për çdo program,.
- Nuk është hartuar udhëzimi i brendshëm për përgatitjen e PBA-së i cili duhej të përmbante: a. Listën e programeve buxhetore dhe përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve; b. Tavanet Përgatitore të PBA 2023-2025 për çdo program, për tre vitet e ardhshme buxhetore. c. Afate të detajuara për Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për përgatitjen e kërkesave të shpenzimeve sipas programeve të PBA-së 2023-2025;
- Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP) nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Kordinatorit të Kordinatori i GMS, brenda muajit prill 2022.
- Nga Kryetari i Bashkisë Konispol nuk është dërguar brenda datës 1 Qershor 2022, pranë MFE, Projekt dokumentin e PBA 2023-2025 të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
- Nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk është paraqitur deri me datë 31 janar për miratim në këshill raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 28.02.2022 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025*", në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*", pikën 6 të nenit 34 në Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*", në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "*Përfinancat e qeverisjes vendore*", neni 34, pika 1. Pika 6, pika 10, pika 33, pika 34, pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 40 në Udhëzimin nr.23, datë 22.11.2016 "*Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore*". (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 nënpika, 1.1,1.2,1.3,1.4 faqe 12-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Konispol.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur Sektori i Financës dhe Buxhetit konstatohet se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara në vitin 2023 paraqitet në masën 96 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave ku vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta është prej 45,052 mijë lekë ose 15 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, konkretisht për Kapitale të Patrupëzuara/Kapitale të Trupëzuara janë

planifikuar në vlerën 96,230 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 92,150 mijë lekë, që do të thotë se Bashkia Konispol në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura për investime, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Këto veprime në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Neni 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 nënpika, 1.1,1.2,1.3,1.4 faqe 12-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Duke analizuar të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Financës dhe Buxhetit lidhur me detyrimet e prapambetura konstatohet se, detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2022, rezulton në vlerën 14,252,000 lekë, detyrimi i krijuar në vitin 2023 është në vlerën 10,788,153 lekë, dhe në total në fund të vitit 2023 rezultojnë detyrime të prapambetura në vlerën 25,040,153 lekë. Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, nuk janë marrë masat për të mbuluar më parë detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101.

Përsa i përket Faturave e pa likuiduara në datën 31.12.2023, konstatohet se, nga auditimi i pagesave të kryera dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Sarandë , u konstatua se për periudhën 2023, ky afat nuk është respektuar në 18 raste për vlerën 24,130,518 lekë, këto për shpenzime për investime, shërbime dhe mirëmbajtje. Nga 18 fatura të pa likuiduara, 9 fituara për vlerën 3,883,160 lekë i përkasin detyrimit të financuar nga të ardhurat e veta, 4 fatura në vlerën 5,244,179 lekë i përkasin detyrimit të financuar nga transfertat e pa kushtëzuara, 1 faturë në vlerën 8,817,725 lekë krijuar nga ministritë e linjës, dhe vlera prej 6,318,251 lekë i përket detyrimit të krijuar nga të ardhurat + transfertat për 4 fatura të pa likuiduara. Gjithashtu në totalin e faturave të pa likuiduara, rezulton se vlera prej 101,104 lekë për investimin “Furnizim me Ujë” investim i financuar nga të ardhurat + transfertat, dhe vlera 165,498 për shërbime postare financuar nga transfertat nuk janë të raportuara në MFE.

Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet radha e likuidimit të tyre, pra ku fatura e parë të likuidohet më parë. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Referuar sa sipër totali i detyrimeve të pa likuiduara në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 25,040 mijë lekë (13.7%) kurse shpenzimet vjetore faktike të vitit 2023 janë në vlerën 182,418 mijë lekë. Detyrimet financiare të konstatuara dhe të pa paguara të Bashkisë Konispol



janë 13.7% të shpenzimeve vjetore faktike në muajin pasues, duke mos e tejkaluar 20% të shpenzimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 nënpika, 1.1,1.2,1.3,1.4 faqe 12-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të marrë masat për rritjen e të ardhurave, duke u ndjekur periodikisht nga personat përgjegjës me qëllim që këshilli bashkiak të jetë në gjendje të kontrollojë dhe monitorojë instrumentet e propozuara për menaxhimin e situatës financiare të Bashkisë. Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2023 paketa Fiskale për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Konispol është miratuar me VKB-në nr. 47, datë 06.12.2022 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti me shkresë nr. 1190/1 prot., datë 22.12.2023. Referuar të dhënave të paraqitura nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023 janë realizuar në masën 62.5%, nga vlera 64.220 mijë lekë të parashikuara është realizuar në vlerën 40,147 mijë lekë. Po ti referohemi akt-rakordimit me thesarin konstatohet se fakti apo realizimi i të ardhurave është në vlerën 33,729 mijë lekë, pasi në këtë rakordim nuk janë përfshirë Grandet dhe Taksa e regjistrimit të automjeteve të përdorura. Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash të cilat nuk planifikohet vlerë për t’u arkëtuar, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton se, metodologjia e përdorur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Pra nuk është bërë parashikimi i të ardhurave për buxhetin, mbi bazën e të dhënave faktike mbi subjektet që i nënshtrohen sistemit fiskal lokal. Sektori i Shërbimit ndaj taksapaguesve nuk është bazuar në të dhënat që disponon dhe në realizimin e të ardhurave të krahasuara me vitet e mëparshme, ku të bëjë parashikimin për fondin e të ardhurave, duke nxjerrë konkluzione për masat që duhet të merren për përmirësimin e punës në të ardhmen. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 47, datë 06.12.2022 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti me shkresë nr. 1190/1 prot., datë 22.12.2023. Rregullore e brendshme nr. 01. Datë 05.01.2022 neni 44 për Miratimin e Rregullores “Mbi Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, nënpika 1.5, faqe 20-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Zyrën e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve dhe Drejtoritë, të marrin masa për një planifikim sa më të saktë të të ardhurave vendore në raport me mundësitë reale të Bashkisë Konispol, duke përmirësuar metodologjinë e përdorur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore duke plotësuar pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Konispol kryhet në programin Excel. Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullohet nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Konispol i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “*Për Sistemin e Taksave Vendore*” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “*Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë*”. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, nënpika 1.5, faqe 20-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol të marrë masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, si dhe bashkëpunim me sektorin e Financave të planifikojnë fonde në buxhet për blerjen e një programi kompjuterik në regjistrimin si të veprimeve financiare po ashtu dhe të veprimtarisë së zyrës së taksave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agjentët tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Konispol (*brenda datës 5 të çdo muaji*), gjë e cila konstatohet nga fakti se në vitin 2023 nuk ka asnjë arkëtim. Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Sarandë në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhjet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo. Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë mosrealizimi. Bashkia Konispol nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Për sa më sipër, Bashkia Konispol nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Konispol, nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj gjithashtu nuk ka filluar procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura. Këto veprime janë në kundërshtim me neni 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “*Për Procedurat Tatimore*”, ku parashikohet se “*Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim,*

agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, nënpika 1.5, faqe 20-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Sektori i Shërbimeve tatimpaguese Bashkia Konispol, të marrë masa për:  
- Evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizimin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se gjendja e llogarive të Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Konispol në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 4,828,836,lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “*Materiale*” në vlerën 407,957 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “*Inventar i imët*” në vlerën 4,420,879 lekë. Gjendja e llogarive të mësipërme nuk është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Nga verifikimi i ditarit të bankës u verifikuan blerje mallrash me vlerë 25,194,903 lekë për të cilat disponohet dokumentacioni hyrës i këtyre mallrave si urdhër furnizim hyrje dhe fletë hyrje në magazinë por nuk është kryer kontabilizimi në llogaritë e klasës 3 (Gjendje inventari qarkullues). Në llogaritë e klasës 3 gjatë vitit 2023 nuk janë kryer kontabilizimet për hyrjet e materialeve dhe mallrave të ndryshme në kundërshtim me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, dhe udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llogaritë e klasës 3 të Aktivit me qëllim paraqitjen e një pamje reale dhe raportimin e saktë të kësaj llogarie në Pasqyrat Financiare.

#### ***Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se Gjendja e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 35,189,189 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 40,099,459 lekë, me rritje për vlerën 4,910,261 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike. Nga analiza e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” u vërtetua se Drejtoria e Financës nuk ka bërë kontabilizimin e detyrimeve nga të ardhurat nga qiratë për tokat bujqësore në vlerën 173,915 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën 246,548 lekë dhe detyrimet në vlerë 1,864,531 lekë të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas Vendimit të Kryetarit të dërguara në Bashkinë Konispol edhe pse kanë dalë urdhër zhdëmtimeve përkatëse, të dala nga Kryetari i Bashkisë sipas planit të veprimit. Veprime në kundërshtim me nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 93. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Konispol të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “*Debitorë të ndryshëm*” me kundërparti llogarinë nr. 470 “*Të ardhura për t’u marrë*”.

#### *Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se llogarit 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 24,011,454 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 24,011,454 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” në mbyllje të vitit 2022 dhe vitit 2023 në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë, 211 “*Pyje, Plantacione*” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 0 lekë. Për këto vlerë nuk ka analiza dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu në vlerat e tyre nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Konispol dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative “*Xarrë*” dhe “*Markat*”.

Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” Kreu II “*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” pika 5, Kreu III. “*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe 211 “*Pyje, Plantacione*” dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

#### *Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2023 rezultoi se, Bashkia Konispol, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2023 paraqitet si aksionare me 4.49% të aksioneve të “*Shoqëria Rajonale U*” SHA me NUIS “*M.....U*” e cila është shoqëri aksionare me objekt, Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Numri i aksioneve është 4,490 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 449,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 4,490 aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Konispol te “*Shoqëria Rajonale U*” Sh.a, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël të vitit 2023, më konkretisht në llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*”, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë nr. 64 datë 22.07.2014 “*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar*” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “*Aktivët Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata jo materiale*” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.

14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1.Rekomandimi:** Nëpunësit zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 4.49% në kapitalin e aksioneve tek “Shoqëria Rajonale U.” Sh.a me vlerë 449,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

#### *Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, konstatohet se Drejtoria e Financës nuk disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, nuk jep informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende. Në pasqyrat financiare të vitit 2023 vlera e llogarisë 466 është në vlerën 14,724,478 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

#### *Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 401-408, u konstatua se, kjo llogari rezulton në çelje të vitit 2023 në vlerën 14,756,764 lekë. Gjatë vitit janë bërë shtesa dhe pakësime dhe gjendja në fund të vitit paraqitet në vlerën 25,492,311 lekë. Gjatë vitit rezulton se janë paguar tre fatura në shumën totale prej 13,536,586 lekë të cilat nuk janë çregjistruar nga kjo llogari. Gjendja reale e llogarisë 401-408 duhet të pasqyrohet për vlerën 13,536,586 lekë. Llogaria 401-408 është paraqitur e mbivlerësuar në vlerën 11,955,725 lekë në pasqyrat financiare. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1.Rekomandimi:** Bashkia Konispol, Drejtoria e Financës, të marrë masat e duhura për paraqitjen reale të llogarisë 401-408, duke zbritur vlerën 11,955,725 lekë nga detyrimet kreditore, me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj.

#### *Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024*

**13. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës 2013-2016 sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nëpërmjet

VKM në Bashkinë Konispol janë transferuar 940 pasuri. Në Bashkinë Konispol me VKM nr. 113, date 13.02.2013 janë transferuar 811 pasuri, me VKM Nr. 433, date 08.06.2016 janë transferuar 125 pasuri, me VKM Nr. 1108, date 30.12.2015 janë transferuar 4 pasuri. Nga pasuritë e transferuara 17 pasuri janë pajisur me çertifikatë pronësie, 225 pasuri janë të pajisura me çertifikatë përdorimi dhe 698 pasuri nuk janë pajisur me çertifikatë pronësie.

Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Konispol nuk është rakorduar me Zyren Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si pasojë, inventari rezulton i pa përditësuar. Veprime këto në kundërshtim me neni 37 i ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1.Rekomandim:** Bashkia Konispol duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZVASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

*Brenda datës 31.12.2024*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga Bashkia Konispol nuk është vlerësuar procesi i zbatimit të rekomandimeve, dërguar nga KLSH-ja me shkresën nr. 315/8 prot, datë 25.07.2023, si më poshtë vijon:

-Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar: 13 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 100 %. Nga të pranuarat, është zbatuar **pjesërisht 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 12 masa organizative.**

-Për shpërbllim dëmi janë rekomanduar: 1 masa me vlerë 276,684 lekë, pranuar 100 %, **por që nuk është marrë asnjë masë për zbatim e tij.**

- Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë rekomanduar gjithsej 3 masa me vlerë 3,221,548 lekë, pranuar 100%. Nga të pranuarat, është zbatuar një masë me vlerë 500,000 lekë dhe **nuk janë zbatuar 2 masa me vlerë 2,721,548 lekë.**

-Masa për uljen e detyrimit tatimor është rekomanduar: 1 masë me vlerë 35,189,198 lekë pranuar 100 %, **por që nuk është marrë asnjë masë për zbatim e tij.**

-Për masa disiplinore janë rekomanduar, referuar rekomandimit të KLSH, ku lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë për **fillimin e** procedurave për masë disiplinore, nuk është marrë asnjë masë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j; Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, nënparagraf 3.1,3.2.3.3 faqe 42-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1.Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

## **A. Masa organizative.**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, me atributet e Kryetarit të GMS, si dhe Nëpunësi Autorizues dhe Koordinatori i Riskut, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimin të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Konispol, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

**4.1.Rekomandimi:** Drejtorisë Ekonomike të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llog. 32 “*Inventari i imët*” për shumën 4,420,879 lekë, të bëhet inventarizimi si dhe të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore mbështetur në UMF.

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financë të marrin masa për kontabilizimin e masave shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dërguar në Bashkinë Konispol me shkresat përkatëse.

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin të aktiveve në llogarit . 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe 211 “*Pyje, Plantacione*” dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**7.1.Rekomandimi:** Kryetari I Bashkisë Konispol, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit të trashëguar

nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE. Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

**8.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik.

**9.1.Rekomandimi:** Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “U.Konispol Sh.a me vlerë 299,600,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**10.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**11.1. Rekomandimi** Sektori i Shërbimeve tatimpaguese Bashkia Konispol, të marrë masa për:

- Evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatës dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

## **B. Masa Shpërblim Dëmi**

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës/Buxhet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e sigurimit të ofertës në vlerën **276,684 lekë**.

## **C. Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara.**

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **246,548 lekë** ndaj **11 personave**.



**2.1.Rekomandimi:** Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,000,000 lekë** nga 2 subjektet, *respektivisht*;

- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti I

**3.1.Rekomandimi:** Sektori Shërbimeve Tatimpaguesve Bashkia Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktual të palikujduara nga shoqëria “V.” në vlerën **1,475,000 lekë**.,

**D. Masa për uljen e detyrimit tatimor.**

**1.1. Rekomandimi:** Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **35,189,198 lekë**.

*Menjëherë*

**B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga ASHK, Dega Rajonale Sarandë, rezulton se për periudhën objekt auditimi (01.01.2023 – 31.12.2023), kanë paraqitur kërkesë për pajisje me vërtetim mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, gjithsej 14 persona për vlerë takse të llogaritur prej 291,770 lekë, nga e cila deri me datë 31.12.2023 kanë paguar detyrimet 14 persona për vlerën e sipërcituar. Referuar periudhës përpara vitit 2023 rezulton se gjendja debitorë ngelet e pa ndryshuar. Pra nuk kanë paguar detyrimin **11 persona me vlerë 246,548 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol. Nga kryqëzimi informacionit marrë nga pasqyrat financiare rezulton se detyrimi i sipër përmendur nuk është regjistruar në kontabilitet si vlerë debitorë. Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Konispol, personat përgjegjës, nuk është bërë asnjë njoftim drejtuar ASHK Dega Sarandë, për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet nëse është marrë ose jo certifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, nënpika 1.5, faqe 20-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale”, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **246,548 lekë**.

*Brenda datës 31.12.2024*

**C.MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në territorin e Bashkisë Konispol për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 3 subjekte. Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitet 2023.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve përkatësisht rezulton:

